



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 64

2003

Gusht

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9047 datë 10.7.2003	Për shërbimin ushtarak në Republikën e Shqipërisë.....	2845
Ligj nr.9095 datë 3.7.2003	Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë.....	2854
Ligj nr.9096 datë 3.7.2003	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8308, datë 18.3.1998 "Për transportet rrugore", ndryshuar me ligjin nr.8908, datë 6.6.2002.....	2866
Ligj nr.9097 datë 3.7.2003	Për vlerësimin e konformitetit.....	2872
Ligj nr.9098 datë 3.7.2003	Për integrimin dhe bashkimin familjar të personave që kanë përfituar azil në Republikën e Shqipërisë.....	2875
Ligj nr.9099 datë 3.7.2003	Për një shtesë dhe ndryshim në ligjin nr.8894, datë 14.5.2002 "Për agjencinë e trajtimit të kredive".....	2884

L I G J
Nr.9047, datë 10.7.2003

PËR SHËRBIMIN USHTARAK NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 166 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

K R E U I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Ky ligj përcakton rregullat për kryerjen e shërbimit ushtarak në Republikën e Shqipërisë, të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e shtetasve, të organeve shtetërore e subjekteve private për mobilizimin dhe shërbimin ushtarak.

Neni 2
Përkufizime

Në zbatim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Mobilizimi ushtarak” është detyrimi ligjor i shtetasit, person fizik e juridik, për të marrë pjesë ose për të siguruar plotësimin e njësive e reparteve të strukturave ushtarake me personel, materiale, teknikë, kafshë, automjete e mjete të tjera të nevojshme.

2. “Shërbimi alternativ” është shërbimi i detyrueshëm, i cili kryhet në vend të shërbimit të detyrueshëm ushtarak aktiv nga shtetasi i cili, për arsye ndërgjegjeje, nuk pranon shërbimin me armë në Forcat e Armatosura.

3. “Shërbimi i detyrueshëm ushtarak aktiv” është detyrimi ligjor i shtetasve shqiptarë, meshkuj, sipas kriterëve të përcaktuara me këtë ligj, për të kryer shërbimin me armë në Forcat e Armatosura.

4. “Shërbimi ushtarak në rezervë” është shërbimi që kryhet nga shtetasi shqiptar që ka kryer shërbimin e detyrueshëm ushtarak aktiv ose alternativ dhe ai që ka kapërcyer kufijtë e moshës së caktuar për kryerjen e këtij shërbimi, si dhe ushtaraku (oficeri) i shërbimit ushtarak aktiv i nxjerrë në rezervë, sipas kriterëve të përcaktuara me këtë ligj.

5. “Shërbimi ushtarak” është detyrimi kushtetues i shtetasve shqiptarë për të marrë pjesë në mbrojtjen e Republikës së Shqipërisë dhe për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga pjesëmarrja në organizmat ndërkombëtarë, ku Republika e Shqipërisë është anëtare ose partnere.

6. “Ushtarak i Forcave të Armatosura” është shtetasi që bën pjesë në këto struktura dhe mban uniformën me simbolet përkatëse, të miratuara me ligj.

Neni 3
Llojet e shërbimit ushtarak

1. Shërbimi ushtarak në Republikën e Shqipërisë është i detyrueshëm dhe vullnetar.
2. Shërbimi i detyrueshëm ushtarak rregullohet me këtë ligj. Shërbimi ushtarak vullnetar rregullohet me ligj të veçantë.

Neni 4

Formula e betimit ushtarak

Shtetasi shqiptar, me fillimin e shërbimit ushtarak, bën betimin sipas formulës së mëposhtme:
“Betohe me se do t’i shërbej me besnikëri Republikës së Shqipërisë; do të jem ushtar besnik i popullit tim, luftëtar i denjë, trim e i disiplinuar, do të jem i gatshëm në çdo kohë e vend dhe nuk do të kursej as jetën time për mbrojtjen e interesave të Atdheut. Betohe!”.

Neni 5

Shërbimi i detyrueshëm ushtarak për shtetasin me dy shtetësi

1. Shtetasi shqiptar që ka fituar shtetësi tjetër dhe ka kryer shërbimin e detyrueshëm ushtarak aktiv ose alternativ në shtetin, shtetas i të cilit është, sipas ligjeve të atij shteti, i njihet i kryer ky shërbim.

2. Shtetasi shqiptar që ka fituar shtetësi tjetër dhe ka banim të përhershëm në territorin e Republikës së Shqipërisë:

- a) u nënshtrohet detyrimeve ushtarake në Republikën e Shqipërisë;
- b) është i lirë, deri në moshën 19 vjeç, të zgjedhë nëse do t’u nënshtrohet detyrimeve ushtarake në shtetin tjetër, shtetas i të cilit është.

3. Shtetasi shqiptar që ka kryer shërbimin ushtarak, pavarësisht në cilin shtet, nëse transferohet me banim të përhershëm në njërin prej shteteve, shtetas i të cilave është, është përgjegjës për kryerjen e shërbimit ushtarak në rezervë, vetëm në shtetin ku ka vendbanimin e përhershëm.

4. Për mënyrën e përmbushjes së detyrimeve ushtarake të shtetasit shqiptar, që ka më shumë se një shtetësi, mund të lidhen marrëveshje të veçanta me shtetet përkatëse.

Neni 6

Përkujdesja sociale dhe mbështetja financiare

Përkujdesja sociale dhe sigurimi material e financiar për ushtarakun në shërbim dhe për shtetasin e thirrur për stërvitje e mobilizim rregullohen me ligj.

KREU II

SHËRBIMI I DETYRUESHËM USHTARAK

Neni 7

Llojet e shërbimit të detyrueshëm ushtarak

1. Shërbimi i detyrueshëm ushtarak përfshin:
 - a) shërbimin ushtarak aktiv;
 - b) shërbimin alternativ;
 - c) shërbimin në rezervë.
2. Shërbimi ushtarak aktiv dhe rezervë kryhet në Forcat e Armatosura.
3. Shërbimi alternativ kryhet në institucionet publike ose në Forcat e Armatosura, sipas kritereve të këtij ligji.

Neni 8

Kryerja e shërbimit ushtarak

1. Shtetasi shqiptar, kudo që ndodhet, është i detyruar të kryejë shërbimin ushtarak në Republikën e Shqipërisë, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 5 të këtij ligji.
2. Shërbimi i detyrueshëm ushtarak kryhet nga vetë shtetasi.

Neni 9

Mosha e kryerjes së shërbimit

1. Shërbimi i detyrueshëm ushtarak aktiv dhe alternativ kryhet nga shtetasi shqiptar mashkull i moshës 19 deri në 27 vjeç, i cili plotëson kriteret e përcaktuara në këtë ligj.

Thirrja e shtetasit për kryerjen e shërbimit të detyrueshëm ushtarak aktiv dhe alternativ fillon sapo mbush moshën 19 vjeç e deri në moshën 26 vjeç.

2. Në rast mobilizimi të përgjithshëm ose të pjesshëm, me ligj ose me dekret të Presidentit të Republikës, thirret për shërbim ushtarak edhe shtetasi i moshës 18 vjeç.

3. Shërbimi i detyrueshëm ushtarak në rezervë kryhet nga shtetasit e moshës:

a) deri në 45 vjeç për ushtarë dhe nënoficerë meshkuj;

b) deri në 35 vjeç për ushtare dhe nënoficere femra;

c) deri në 50 vjeç për oficerë meshkuj;

ç) deri në 40 vjeç për oficere femra.

Neni 10

Kohëzgjatja e shërbimit

1. Kohëzgjatja e shërbimit të detyrueshëm ushtarak aktiv ose alternativ është 12 muaj. Shtetasit shqiptarë që kanë përfunduar shkollat e larta universitare me shkëputje nga puna, brenda ose jashtë vendit, në përshtatje me diplomimin e tyre dhe sipas përcaktimeve që bën Ministri i Mbrojtjes kryejnë shërbimin e detyrueshëm ushtarak aktiv ose alternativ për një periudhë 1-mujore.

2. Kohëzgjatja e shërbimit ushtarak në rezervë është 4 deri në 7 ditë në vit.

Për nevoja të stërvitjeve ushtarake, që zgjasin më shumë se 4 deri në 7 ditë në vit, Ministri i Mbrojtjes urdhëron bashkimin e ditëve të stërvitjes të dy viteve në një vit, por jo më shumë se 14 ditë.

3. Periudha e shërbimit të detyrueshëm ushtarak aktiv, rezervë dhe shërbimit alternativ mund të zgjatet mbi kohën e përcaktuar në pikat 1 dhe 2 të këtij neni vetëm në rastet kur vendosen masat e jashtëzakonshme, sipas kriterëve të përcaktuara me ligj.

Neni 11

Kriteret e mosnjohjes së shërbimit të detyrueshëm ushtarak aktiv dhe alternativ

Në kohën e plotë të kryerjes së shërbimit të detyrueshëm ushtarak aktiv dhe alternativ, për shtetasin që hyn në këtë shërbim, nuk përfshihet:

a) koha e vuajtjes së dënimit me burg;

b) koha e ndërprerjes së këtij shërbimi pa shkaqe ligjore.

Neni 12

Kriteret e mosthirrjes në shërbimin e detyrueshëm ushtarak aktiv dhe alternativ

Nuk thirret për kryerjen e shërbimit të detyrueshëm ushtarak aktiv dhe alternativ:

a) shtetasi i cili del i paaftë nga komisioni mjekësor;

b) shtetasi që ka nën kujdestari prindër ose pjesëtarë të familjes, invalidë të plotë, që kanë nevojë për përkujdesje dhe që nuk kanë përkujdesje tjetër;

c) shtetasi kryefamiljar, i martuar dhe me dy e më tepër fëmijë të mitur;

ç) shtetasi që është duke kryer vuajtjen e dënimit me heqje lirie ose për të cilin zbatohet masa e sigurisë me burg.

Shtetasi i parashikuar në shkronjën “ç” të këtij neni nuk thirret në shërbimin e detyrueshëm ushtarak aktiv dhe alternativ, për sa kohë që përfshihet në kushtet e parashikuara në këtë nen.

Neni 13

Shtyrja e afatit të kryerjes së shërbimit

Qendra e rekrutim-mobilizimit ka të drejtë të shtyjë afatin e thirrjes së shtetasit për kryerjen e shërbimit të detyrueshëm ushtarak aktiv dhe alternativ në rastet kur:

a) shtetasi del përkohësisht i paaftë për këtë shërbim nga komisioni mjekësor;

b) shtetasi vazhdon studimet në shkollën e mesme, në universitete ose shkolla të larta brenda ose jashtë vendit;

c) familja është në gjendje të vështirë ekonomike, por thirrja nuk mund të shtyhet më shumë se 2 vjet.

ç) shtetasi zgjidhet në zgjedhjet e përgjithshme ose ato vendore, si dhe kur shtetasi vazhdon studime pasuniversitare.

Neni 14

Lirimi para kohe

Shtetasi në shërbimin e detyrueshëm ushtarak aktiv ose alternativ lirohet para kohe nga ky shërbim në rastet kur:

a) cilësohet i paaftë për vazhdimin e shërbimit me vendim të Komisionit Mjekësor të Spitalit Ushtarak Qendror Universitar;

b) për fatkeqësi familjare të rënda, kur prindi ose bashkëshortja bëhet invalid ose vdes dhe fëmijët mbeten pa përkujdesje;

c) pranohet student në shkollat e larta ushtarake ose në Akademinë e Policisë.

Për rastet e parashikuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të këtij neni, urdhri i lirimit lëshohet nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Neni 15

Ndërprerja e përkohshme e shërbimit

1. Shtetasi në shërbimin e detyrueshëm ushtarak aktiv ose alternativ e ndërpret përkohësisht këtë shërbim në rastet kur:

a) me vendim të Komisionit Mjekësor të Spitalit Ushtarak Qendror Universitar del përkohësisht i paaftë për vazhdimin e këtij shërbimi;

b) pjesëtarë të familjes, të cilët janë në ngarkim të tij, sëmuren për një kohë të gjatë.

2. Ndërprerja e përkohshme e shërbimit të detyrueshëm ushtarak aktiv ose alternativ aktiv bëhet vetëm një herë dhe jo më shumë se 6 muaj.

Neni 16

Kriteret e njohjes së shërbimit

1. I njihet i kryer shërbimi i detyrueshëm ushtarak aktiv shtetasit shqiptar, i cili fillon studimet në shkollat e larta ushtarake ose në një akademi policie, brenda ose jashtë vendit, nga dita e pranimit në këto shkolla.

2. Kur shtetasi që ndërpret studimet në këto shkolla, pa shkaqe të ligjshme, ose përjashtohet nga shkolla ose akademja, nuk e ka plotësuar kohën e kryerjes së shërbimit të detyrueshëm ushtarak aktiv, është i detyruar ta plotësojë atë si ushtar.

Neni 17

E drejta e ruajtjes së vendit të punës

Shtetasi, i cili i ndërpret marrëdhëniet (kontratën) e punës për shkak të detyrimit për kryerjen e shërbimit të detyrueshëm ushtarak aktiv ose alternativ, ka të drejtën e rikthimit në vendin e punës.

Subjektet shtetërore janë të detyruara ta ripunësojnë atë.

Neni 18

Të drejtat e shtetasit në shërbimin ushtarak aktiv ose alternativ

Shtetasi, gjatë kryerjes së shërbimit të detyrueshëm ushtarak aktiv ose alternativ, përfiton këto të drejta:

a) koha e shërbimit i njihet vjetërsi pune, për efekt sigurimi e pensioni;

b) shërbim shëndetësor pa pagesë në institucionet shëndetësore shtetërore, brenda ose jashtë

vendit;

c) rimbursim të shpenzimeve të transportit, kur thirret ose lirohet nga shërbimi, kur dërgohet me leje pranë familjes, si dhe shërbim postar pa pagesë;

ç) trajtim me pagë dhe shpërblim, sipas vështirësisë së shërbimit, të përcaktuar në aktet ligjore.

d) leje, sipas kritereve të përcaktuara me urdhra dhe udhëzime të Ministrit të Mbrojtjes.

Neni 19

Kufizimet për moskryerjen e shërbimit ushtarak aktiv ose alternativ

Shtetasit shqiptar, që nuk e ka kryer fizikisht shërbimin e detyrueshëm ushtarak aktiv ose kursin profesional përkatës, i ndalohej punësimi si ushtar me pagesë ose nënoficer në Forcat e Armatosura, në rolin bazë të Policisë së Shtetit, në Gardën e Republikës dhe në policitë e tjera të krijuara me ligj.

Neni 20

Kërkesa për shërbim alternativ

1. Shtetasi, që për arsye ndërgjegjeje nuk pranon të kryejë shërbimin me armë në Forcat e Armatosura dhe kërkon të kryejë në vend të tij shërbim alternativ, duhet të paraqesë kërkesën së bashku me dokumentacionin shoqërues në qendrën e rekrutim-mobilizimit 6 (gjashtë) muaj përpara se të plotësojë moshën ligjore të thirrjes për kryerjen e shërbimit të detyrueshëm ushtarak.

2. Dokumentacioni që duhet të shoqërojë kërkesën për kryerjen e shërbimit alternativ përcaktohet me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes.

3. Qendra e rekrutim-mobilizimit pasi shqyrton kërkesën, ia përcjell, së bashku me një relacion, Komisionit të Shërbimit Alternativ pranë Ministrisë së Mbrojtjes.

Neni 21

Komisioni i Shërbimit Alternativ

1. Për njohjen e të drejtës së shtetasit për kryerjen e shërbimit alternativ krijohet Komisioni i Shërbimit Alternativ pranë Ministrisë së Mbrojtjes.

2. Komisioni i Shërbimit Alternativ shqyrton kërkesat dhe dokumentacionin e paraqitur, si dhe merr vendimin përfundimtar.

3. Përbërja, funksionimi, detyrat dhe të drejtat e Komisionit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 22

Kryerja e shërbimit alternativ

1. Shtetasi të cilit, me vendim të Komisionit të Shërbimit Alternativ, i njihet e drejta për ta kryer detyrimin ushtarak në shërbimin alternativ, e kryen atë në:

- a) institucionet e shërbimit publik;
- b) njësitë e qeverisjes vendore, për shërbime të ndryshme publike;
- c) organizata jofitimprurëse me karakter humanitar;
- ç) shërbimin e mbrojtjes së mjedisit;
- d) shërbimin e zjarrfikësve.

2. Institucionet e përmendura në pikën 1 të këtij neni janë të detyruara të paraqesin në Ministrinë e Punës dhe të Çështjeve Sociale vendet e punës ku mund të kryhet shërbimi alternativ.

Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale bashkërendon punën me institucionet e përmendura në pikën 1 të këtij neni dhe në çdo fund viti dërgon pranë Ministrisë së Mbrojtjes, me shkrim, numrin e vendeve të punës për këtë shërbim.

3. Shtetasi, me dëshirën e vet, mund ta kryejë shërbimin alternativ, sipas aftësive dhe profesionit civil që ka, në Forcat e Armatosura, në shërbimet e logjistikës, të shëndetësisë, transportit, riparim-mirëmbajtjes dhe në vende të tjera pune, ku nuk është e nevojshme mbajtja dhe përdorimi i

armës.

Neni 23

Detyrimet e institucionit ku kryhet shërbimi alternativ

Institucioni, ku shtetasi kryen shërbimin alternativ, detyrohet të sigurojë kushte normale pune, fjetjeje, ushqimi, rroba pune dhe pagesë, në përputhje me kriteret dhe normat e përcaktuara për ushtarin e shërbimit të detyrueshëm ushtarak aktiv.

Neni 24

Plotësimi i njërive dhe reparteve të Forcave të Armatosura me personel rezervist

Plotësimi i njërive dhe reparteve të Forcave të Armatosura me personel rezervist bëhet sipas kriterëve të përcaktuara me rregullore të veçantë, të miratuar nga Ministri i Mbrojtjes.

Neni 25

Përfshirja nga shërbimi ushtarak në rezervë

Përfshirëhet nga thirrja për të marrë pjesë në shërbimin ushtarak në rezervë shtetasi që kryen detyrat e deputetit, ministrit, prefektit, kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore, gjyqtarët, prokurorët, kryetarët e partive politike parlamentare, drejtuesit e institucionit fetar, përfaqësuesi diplomatik ose konsullor, si dhe shtetasi që ndodhet jashtë shtetit me studime ose për t'u kuruar dhe persona që, nga ministrinë ose institucionet e tjera qendrore, përcaktohen si persona që kanë detyra të rëndësishme, ndërprerja e të cilave cenon sektorët jetikë të vendit.

KREU III

DETYRIMET E ORGANEVE SHETETËRORE, TË SUBJEKTEVE PRIVATE E TË SHETETASVE PËR SHËRBIMIN USHTARAK DHE MOBILIZIMIN

Neni 26

Qendra e rekrutim-mobilizimit

Qendra e rekrutim-mobilizimit krijohet dhe funksionon si strukturë pranë çdo qarku dhe varet nga ana administrative nga Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura.

Neni 27

Përgjegjësia e qendrës së rekrutim-mobilizimit

1. Qendra e rekrutim-mobilizimit përgjigjet për zbatimin e programit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, për përcaktimin, sigurimin e personelit të nevojshëm për shërbimin e detyrueshëm ushtarak aktiv ose atë rezervist, për plotësimin e njërive e të reparteve të Forcave të Armatosura.

2. Për mënyrën e rekrutimit të shtetasve, që kanë detyrim për kryerjen e shërbimit të detyrueshëm ushtarak aktiv, dhe lajmërimin e rezervistëve, në rast mobilizimi e stërvitjeje, qendra e rekrutim-mobilizimit përgjigjet edhe para prefektit të qarkut.

Neni 28

Komisionet mjekësore të kontrollit të aftësive për shërbim ushtarak

1. Për kontrollin e aftësive të shtetasit për shërbim ushtarak, në qendrën e rekrutim-mobilizimit krijohet komisioni mjekësor i kontrollit të aftësive fizike e shëndetësore të shtetasit që thirret në shërbimin ushtarak.

2. Në Spitalin Ushtarak Qendror Universitar krijohet dhe funksionon komisioni mjekësor i kontrollit të aftësive fizike e shëndetësore të ushtarakut dhe të shtetasit që dërgohet nga qendra e rekrutim-mobilizimit të qarkut.

3. Përbërja e komisioneve, detyrat dhe përgjegjësitë përcaktohen në rregulloren e aftësive fizike e shëndetësore të shtetasit dhe ushtarakut, e cila miratohet bashkërisht nga Ministri i Mbrojtjes dhe Ministri i Shëndetësisë.

Neni 29

Marrja e shtetasit në evidencë

1. Evidentimi i shtetasve meshkuj, si burime njerëzore për kryerjen e detyrimit të shërbimit ushtarak aktiv, fillon në moshën 17 vjeç.
2. Shtetasit shqiptarë merren në evidencë me hyrjen në shërbimin ushtarak.

Neni 30

Heqja e shtetasit nga evidenca ushtarake

Shtetasi shqiptar hiqet nga evidenca ushtarake kur:

- a) deklarohet i paafte për shërbim ushtarak me vendim të komisionit mjekësor;
- b) mbush moshën e përcaktuar në pikën 3 të nenit 9 të këtij ligji;
- c) lë shtetësinë shqiptarë;
- ç) vdes.

Neni 31

Detyrimet e shtetasit për evidencën ushtarake

1. Shtetasi shqiptar ka për detyrë të paraqitet në qendrën e rekrutim-mobilizimit për kontrollin e aftësive fizike e shëndetësore, për t'u marrë në evidencë ushtarake, kur mbush moshën 17 vjeç.
2. Shtetasi është i detyruar të paraqitet në qendrën e rekrutim-mobilizimit, kur ndryshon vendbanimin, shtetësinë, të dhënat në regjistrin themeltar të shtetasve, si dhe kur lirohet nga shërbimi i detyrueshëm ushtarak aktiv.
3. Shtetasi, i cili largohet jashtë shtetit mbi 6 muaj dhe ka detyrim për shërbimin ushtarak, është i detyruar të paraqitet në qendrën e rekrutim-mobilizimit për të bërë veprimet përkatëse, duke njoftuar më parë strukturën ku kryen shërbimin ushtarak.

Neni 32

Dokumentacioni për shërbimin ushtarak

Dokumentacioni për evidentimin, identifikimin dhe përpunimin e të dhënave të shërbimit ushtarak në qendrën e rekrutim-mobilizimit ose në strukturat e tjera të Forcave të Armatosura, si dhe modelet përkatëse të tyre përcaktohen me rregullore të miratuara nga Ministri i Mbrojtjes.

Neni 33

Detyrimet në rast mobilizimi të shtetasve

1. Shtetasi, i cili ka detyrimin për shërbimin ushtarak, kur lajmërohet me fletëthirrje për të kryer shërbimin e detyrueshëm ushtarak, për stërvitje ose merr lajmërimin për mobilizim, detyrohet të paraqitet në qendrën e rekrutim-mobilizimit ose në strukturën përkatëse ushtarake.
2. Ushtaraku i shërbimit aktiv ose rezervist, në rastet e pamundësisë së paraqitjes për arsye madhore, me të marrë njoftim, vë në dijeni, në vendin e kohën e caktuar, strukturën përkatëse.

Neni 34

Detyrimet e njësisë së qeverisjes vendore

1. Njësitë e qeverisjes vendore, nëpërmjet zyrave të gjendjes civile, detyrohen që, brenda muajit tetor të çdo viti, t'u japin qendrave të rekrutim-mobilizimit listën emërore të shtetasve (meshkuj), të cilët vitin pasardhës mbushin moshën 17 vjeç.
2. Bashkitë (njësitë bashkiake) dhe komunat lajmërojnë dhe sigurojnë paraqitjen e shtetasit, që

thirret për kryerjen e shërbimit ushtarak, në bazë të listëthirrjeve dhe fletëthirrjeve të dërguara nga qendrat e rekrutim-mobilizimit ose njësitë e repartet ushtarake.

3. Shpenzimet për lajmërimin e shtetasve mbulohen nga Buxheti i Shtetit, sipas kritereve e rregullave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 35

Detyrimet e institucioneve arsimore

Institucionet e arsimit të lartë, publik dhe privat, detyrohen që, me fillimin e vitit akademik e në vazhdimësi, t'u paraqesin qendrave të rekrutim-mobilizimit listën emërore të shtetasve (meshkuj) që regjistrohen, përfundojnë, përjashtohen ose largohen nga shkollat, brenda ose jashtë vendit.

Neni 36

Detyrimet e institucioneve të drejtësisë

Ministria e Drejtësisë, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, detyrohet:

a) të njoftojë qendrën e rekrutim-mobilizimit të qarkut, ku shtetasi ka vendbanimin, brenda 15 ditëve nga dita që shtetasi i dënuar me burg e që plotëson kriteret e përcaktuara në këtë ligj për kryerjen e shërbimit të detyrueshëm ushtarak, dërgohet për të vuajtur dënimin;

b) të njoftojë qendrën e rekrutim-mobilizimit të qarkut, ku shtetasi ka vendbanimin, për përfundimin e dënimit nga shtetasi, 30 ditë përpara përfundimit.

Neni 37

Detyrimet e institucioneve shëndetësore

1. Institucionet shëndetësore detyrohen të dërgojnë mjekë në komisionet mjekësore të qendrave të rekrutim-mobilizimit.

2. Pagesa për mjekët, që marrin pjesë në këto komisione, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 38

Mobilizimi ushtarak

Mobilizimi ushtarak në Republikën e Shqipërisë kryhet në kohë paqe ose në kohë lufte. Mobilizimi është i përgjithshëm ose i pjesshëm.

Kriteret e vendosjes së gjendjes së mobilizimit dhe të çmobilizimit, të përgjithshëm ose të pjesshëm, përcaktohen me ligj.

Neni 39

Mobilizimi ushtarak në kohë paqe

1. Mobilizimi ushtarak në kohë paqe planifikohet, organizohet e drejtohet në përputhje me synimet dhe përcaktimet në dokumentin e politikës së mbrojtjes, të strategjisë së sigurimit dhe strategjisë ushtarake të Republikës së Shqipërisë, nga Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, komandat e forcave dhe ato të mbështetjes.

2. Koha e thirrjes dhe e lirit, kriteret e përzgjedhjes dhe mënyra e organizimit të rekrutim-mobilizimit të shtetasit për kryerjen e shërbimit të detyrueshëm ushtarak aktiv ose alternativ përcaktohen me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes.

3. Mobilizimi i forcave rezervë, për zhvillimin e stërvitjeve dhe të veprimtarive të tjera, bëhet nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, komandantët e forcave dhe ata të mbështetjes, në bazë të programeve vjetore të miratuara nga Ministri i Mbrojtjes.

Neni 40
Kundërvajtjet administrative

1. Përbën kundërvajtje administrative, në kuptim të këtij ligji, dhe dënohet me gjobë nga 3000 deri në 30 000 lekë, shmangia nga:

- a) detyrimet në fushën e evidencës ushtarake;
- b) thirrja për të kryer shërbimin e detyrueshëm ushtarak aktiv ose alternativ;
- c) thirrja për stërvitje ushtarake ose nga prova e gatishmërisë ose e mobilizimit.

2. Shmangia nga detyrimet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, kur kryhet më shumë se 1 herë, përbën kundërvajtje penale, sipas Kodit Penal Ushtarak.

3. Pranë çdo qendre rekrutim-mobilizimi, për shqyrtimin e shkeljeve që përbëjnë kundërvajtje administrative, krijohet komisioni i shqyrtimit të kundërvajtjeve.

Neni 41
Ekzekutimi i gjobës

Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative, ankimi ndaj vendimeve të komisionit të shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative dhe ekzekutimi i tyre bëhen në përputhje me dispozitat e ligjit nr.7687, datë 7.4.1993 “Për kundërvajtjet administrative”, i ndryshuar dhe Kodit të Procedurës Civile.

KREU IV
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 42
Shlyerja e detyrimit të shërbimit të detyrueshëm ushtarak aktiv ose alternativ me pagesë

Shtetasit shqiptar, që plotëson kriteret e vendosura nga ky ligj për kryerjen e detyrimit të shërbimit të detyrueshëm ushtarak aktiv ose alternativ, mund t’i njihet i shlyer ky detyrim kur, me dëshirën dhe kërkesën e vet, paguan personalisht dhe menjëherë një shumë të caktuar lekësh.

Kriteret dhe shuma e detyrimit në këto raste përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Ky nen do të zbatohet deri më 31 dhjetor 2010.

Neni 43
Nxjerrja e akteve nënligjore

Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Mbrojtjes nxjerrin aktet nënligjore të nevojshme në zbatim të këtij ligji, brenda gjashtë muajve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit.

Neni 44
Shfuqizimet

Kreu I “Dispozita të përgjithshme”, nenet 1, 2 dhe 3, Kreu II “Shërbimi ushtarak”, nenet 5 deri në 27, Kreu IV “Evidenca ushtarake”, nenet 33 deri në 45 dhe Kreu V nenet 46, 47, 48 dhe 49 të ligjit nr.7978, datë 26.7.1995 “Për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, si dhe çdo dispozitë tjetër, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 45
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3914, datë 30.7.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

L I G J
Nr.9095, datë 3.7.2003

PËR SHËRBIMIN E JASHTËM TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

PJESA E PARË
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Objekt i këtij ligji është rregullimi i veprimtarisë së shërbimit të jashtëm, i organizimit, bashkërendimit dhe funksionimit të organeve, që ushtrojnë shërbimin e jashtëm dhe i statusit të diplomatëve.

Neni 2

Baza juridike e veprimtarisë së organeve të shërbimit të jashtëm

Organet që ushtrojnë shërbimin e jashtëm janë:

Ministria e Punëve të Jashtme dhe strukturat e tjera në varësi të saj, të cilat e ushtrojnë veprimtarinë dhe funksionet e shërbimit të jashtëm në përputhje me Kushtetutën, me këtë ligj dhe me aktet normative të nxjerra në zbatim të tij, bazuar në programin e Qeverisë dhe orientimet e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 3

Bashkëpunimi me Kuvendin e Republikës së Shqipërisë

1. Ministria e Punëve të Jashtme, brenda detyrave dhe përgjegjësi të veta, njofton Kuvendin e Republikës së Shqipërisë për çështje të rëndësishme të politikës së jashtme.

2. Ministria e Punëve të Jashtme i propozon Këshillit të Ministrave të paraqesë përpara Kuvendit çështje të rëndësishme të politikës së jashtme, për të cilat është e nevojshme që të mbahet qëndrim nga Kuvendi.

Neni 4

Bashkëpunimi me Presidentin e Republikës

Ministria e Punëve të Jashtme, brenda detyrave dhe përgjegjësi të veta, njofton Presidentin e Republikës për çështjet e rëndësishme të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe, me kërkesë të Presidentit të Republikës ose me nismën e vet, jep mendime dhe bën propozime për veprimtaritë ndërkombëtare, që kryhen nga Presidenti i Republikës.

Neni 5

Bashkëpunimi me institucionet e tjera

1. Ministrinë, institucionet qendrore dhe organet e pushtetit vendor ushtrojnë funksione të marrëdhënieve me jashtë brenda fushës së veprimtarisë së tyre. Në ushtrimin e këtyre funksioneve ato veprojnë në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe e njoftojnë atë për çdo veprimtari.

2. Këshilli i Ministrave nxjerr aktet përkatëse, që përcaktojnë rregullat për ushtrimin e funksioneve të marrëdhënieve me jashtë të institucioneve të tjera dhe marrëdhëniet e tyre me Ministrinë e Punëve të Jashtme.

PJESA E DYTË INSTITUCIONET E SHËRBIMIT TË JASHTËM

KREU I MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME

Neni 6 **Funksionet e Ministrisë së Punëve të Jashtme**

Ministria e Punëve të Jashtme harton, përpunon, organizon dhe zbaton politikën e jashtme të shtetit shqiptar. Veçanërisht, Ministria e Punëve të Jashtme realizon:

- a) shprehjen dhe mbrojtjen e interesave të shtetit shqiptar në marrëdhëniet ndërkombëtare me shtetet e tjera dhe organizatat ndërkombëtare;
- b) përgatitjen e të dhënave, raporteve ose rekomandimeve për Kuvendin, Këshillin e Ministrave, Presidentin e Republikës, si dhe për institucionet e tjera shtetërore, për përcaktimin e qëndrimeve dhe marrjen e masave të nevojshme për çështje të rëndësishme, që kanë të bëjnë me politikën e jashtme të Republikës së Shqipërisë;
- c) mbrojtjen e të drejtave të shtetasve shqiptarë, me banim të përhershëm ose të përkohshëm jashtë vendit dhe të të drejtave të njohura ndërkombëtare, të komuniteteve shqiptare në vende të ndryshme, në bashkëpunim me organet e tjera përgjegjëse;
- ç) komunikimin me përfaqësitë diplomatike e konsullore të shteteve të tjera, si dhe me misionet e organizatave ndërkombëtare të akredituara në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me praktikën diplomatike;
- d) depozitimin e marrëveshjeve origjinale ndërkombëtare, të lidhura në emër të shtetit dhe të Qeverisë Shqiptare;
- dh) përpunimin, ruajtjen dhe arkivimin e të gjithë dokumentacionit të veprimtarisë së shërbimit të jashtëm;
- e) të gjitha detyrat e tjera që rrjedhin nga përcaktimet e këtij ligji ose aktet e tjera normative.

Neni 7 **Drejtimi i Ministrisë së Punëve të Jashtme**

Ministria e Punëve të Jashtme drejtohet nga Ministri i Punëve të Jashtme, i cili, në ushtrimin e funksioneve, ndihmohet nga zëvendësministri/at i/e Punëve të Jashtme dhe Sekretari i Përgjithshëm i kësaj Ministrie.

Neni 8 **Ministri i Punëve të Jashtme**

1. Ministri i Punëve të Jashtme drejton dhe përfaqëson shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë.

2. Në përmbushjen e funksioneve, Ministri i Punëve të Jashtme siguron zbatimin e programit të Këshillit të Ministrave për politikën e jashtme dhe, në bazë të këtij programi, harton dhe përpunon objektivat politikë të Ministrisë që ai drejton.

Neni 9 **Zëvendësministri/at i/e Punëve të Jashtme**

1. Zëvendësministri/at e Punëve të Jashtme ndihmojnë Ministrin e Punëve të Jashtme në drejtimin e Ministrisë dhe zbatimin e programit të Këshillit të Ministrave.

2. Qëllimi i punës së tij/tyre është t'i sigurojë/sigurojnë Ministrit bashkëpunim e këshillim

politik për çështje të caktuara të politikës së jashtme, sipas detyrave të ngarkuara prej tij.

Neni 10

Sekretari i Përgjithshëm

1. Sekretari i Përgjithshëm është nëpunësi më i lartë civil i shërbimit të jashtëm.
2. Sekretari i Përgjithshëm ndihmon Ministrin në hartimin dhe përpunimin e objektivave diplomatike të Ministrisë së Punëve të Jashtme, bashkërendon punën e njërive të brendshme të Ministrisë dhe të përfaqësive diplomatike jashtë vendit, si dhe siguron vazhdimësinë e veprimtarisë në Ministri.
3. Ai caktohet në këtë post nga radhët e diplomatëve me gradën ambasador, me konkurrim të hapur.

Neni 11

Struktura e Ministrisë së Punëve të Jashtme

Veprimtaria e shërbimit me jashtë në Ministrinë e Punëve të Jashtme kryhet nëpërmjet strukturave të saj, të cilat krijohen dhe funksionojnë sipas drejtimeve dhe objektivave të caktuar për realizimin e politikës së jashtme.

Neni 12

Protokolli i Shtetit

1. Në Ministrinë e Punëve të Jashtme funksionon zyra e Protokollit të Shtetit, e cila ka për detyrë:
 - a) organizimin dhe realizimin e të gjithë veprimtarisë kryesore protokollare të Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit dhe Ministrit të Punëve të Jashtme për të gjithë veprimtarinë e tyre brenda dhe jashtë vendit;
 - b) bashkërendimin e veprimtarisë protokollare të anëtarëve të Këshillit të Ministrave dhe të drejtuesve të institucioneve të larta qendrore;
 - c) bashkërendimin dhe zbatimin e programit të vizitave të delegacioneve të huaja të nivelit të lartë.
2. Veprimtaria e zyrës së Protokollit të Shtetit rregullohet me akte të veçanta ligjore ose nënligjore.

Neni 13

Edukimi dhe formimi profesional

Për edukimin dhe formimin profesional të diplomatëve, pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme ngrihet Akademia Diplomatike, funksionimi i së cilës rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU II

PËRFAQËSITË DIPLOMATIKE JASHTË VENDIT

Neni 14

Kategoritë e përfaqësive diplomatike

1. Përfaqësitë diplomatike të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit janë:
 - a) misionet diplomatike;
 - b) postet konsullore.
2. Në misionet diplomatike bëjnë pjesë ambasadat dhe misionet e përhershme në organizatat ndërkombëtare, ndërsa në postet konsullore bëjnë pjesë konsullatat e përgjithshme, konsullatat, nënkonsullatat dhe zyrat konsullore.

Neni 15

Hapja dhe mbyllja e përfaqësive diplomatike

1. Përfaqësitë diplomatike hapen dhe mbyllen me vendim të Këshillit të Ministrave, në bazë të propozimit të Ministrit të Punëve të Jashtme.

2. Mënyra e funksionimit, struktura dhe numri i punonjësve të përfaqësive diplomatike përcaktohen nga Ministri i Punëve të Jashtme.

Neni 16

Funksionet e misionit diplomatik

1. Misioni diplomatik i Republikës së Shqipërisë ushtron funksionet në përputhje me Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike të vitit 1961, me këtë ligj dhe me akte të tjera në zbatim të tij. Misioni diplomatik ka këto funksione kryesore:

a) të përfaqësojë Republikën e Shqipërisë në shtetin pritës ose në organizatat ndërkombëtare;
b) të mbrojë në shtetin pritës interesat e Republikës së Shqipërisë dhe të shtetasve ose personave juridikë të saj, brenda kufijve të lejuar nga e drejta ndërkombëtare;

c) të nxisë zhvillimin e marrëdhënieve politike, ekonomike, kulturore, arsimore, shkencore, teknologjike, të informacionit, diplomatiko-konsullore dhe në çdo fushë tjetër ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shtetit pritës, në një frymë miqësore e bashkëpunimi;

ç) t'i japë të dhëna Ministrisë së Punëve të Jashtme për zhvillimet ekonomike, politike dhe sociale të shtetit pritës dhe për veprimtarinë e organizatave ndërkombëtare, pranë të cilave është akredituar;

d) të bashkëpunojë me delegacionet e Republikës së Shqipërisë në bisedimet që zhvillohen në shtetin pritës dhe të marrë pjesë në bisedime me qeverinë e shtetit pritës në përgatitjen për nënshkrim të marrëveshjeve ndërkombëtare, si dhe në veprimtarinë e konferencave ndërkombëtare.

2. Misioni diplomatik kryen edhe funksione ose veprimtari të tjera, për të cilat autorizohet nga Ministria e Punëve të Jashtme, sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe akteve të tjera normative.

Neni 17

Kryerja e funksioneve konsullore

Misioni diplomatik kryen edhe funksione konsullore në shtetin pritës. Nëse ka poste konsullore të Republikës së Shqipërisë në të njëjtin shtet, misioni kryen funksione konsullore në atë pjesë të territorit që nuk përfshihet në juridiksionin e postit konsullor. Funksionet konsullore ushtrohen nga një diplomat i misionit diplomatik, i ngarkuar për veprimtarinë konsullore, me miratimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, në përputhje me ligjin nr.8372, datë 9.7.1998 "Për ushtrimin e funksioneve konsullore nga përfaqësitë diplomatike ose konsullore" dhe aktet e tjera nënligjore.

Neni 18

Funksionet e postit konsullor

1. Posti konsullor ushtron funksionet në përputhje me Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Konsullore të vitit 1963, me këtë ligj, me ligjin nr.8372, datë 9.7.1998 "Për ushtrimin e funksioneve konsullore nga përfaqësitë diplomatike ose konsullore", si dhe me akte të tjera normative.

2. Funksionet kryesore të postit konsullor janë:

a) të mbrojë interesat e Republikës së Shqipërisë, të shtetasve ose personave juridikë të saj, të cilët ndodhen në zonën e tij të juridiksionit konsullor, brenda kufijve të lejuar nga e drejta ndërkombëtare në shtetin pritës;

b) të punojë për zhvillimin e marrëdhënieve me shtetin pritës në fushat e ekonomisë, tregtisë, kulturës, shkencës dhe informacionit;

c) t'i japë të dhëna Ministrisë së Punëve të Jashtme për zhvillimet ekonomike, tregtare, kulturore e shkencore në shtetin pritës;

ç) të njoftojë organet përkatëse të shtetit pritës, në zonën e tij konsullore, për kushtet dhe gjendjen ekonomike, tregtare, kulturore e shkencore në Republikën e Shqipërisë.

3. Posti konsullor kryen edhe funksione ose veprimtari të tjera, për të cilat autorizohet nga Ministria e Punëve të Jashtme, në mbështetje të akteve normative, të cilat:
nuk janë të ndaluara me ligj ose me ndonjë akt tjetër në shtetin pritës;
b) shteti pritës nuk i kundërshton;
c) parashikohen në marrëveshjet ndërkombëtare, në fuqi, ndërmjet shtetit tonë dhe shtetit pritës.

Neni 19

Misioni special

1. Misioni special është një mision i përkohshëm, që përfaqëson Republikën e Shqipërisë në një shtet tjetër ose organizatë ndërkombëtare, me pëlqimin e tyre, për të negociuar ose kryer detyra të posaçme.
2. Mënyra e krijimit, përbërja dhe funksionet e misionit special përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme.

Neni 20

Personeli i përfaqësive diplomatike

1. Personeli i përfaqësive diplomatike përbëhet nga diplomatët dhe nga staf i administrativ e teknik.
2. Në personelin e përfaqësive diplomatike mund të përfshihen edhe nëpunës, të emëruar nga Ministri i Punëve të Jashtme, në bazë të një marrëveshjeje me shkrim, të arritur me institucionet e tjera, për të kryer detyra në fushën ekonomike, kulturore, shkencore e të mbrojtjes dhe në çdo fushë tjetër për një kohë të përcaktuar. Gjatë kohës së shërbimit në përfaqësinë diplomatike, këta nëpunës gëzojnë të njëjtin status me diplomatët dhe pas përfundimit të këtij shërbimi rikthehen në pozicionin e mëparshëm, duke rifituar statusin që kanë pasur ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.

Neni 21

Shefi i përfaqësive diplomatike

1. Misioni diplomatik drejtohet nga ambasadori ose i ngarkuari me punë.
2. Ambasadorët emërohen dhe lirohen nga Presidenti i Republikës, me propozimin e Kryeministrit. Ministri i Punëve të Jashtme i paraqet Kryeministrit propozimet përkatëse për emërimin dhe lirimin e ambasadorëve.
Përpara emërimit të ambasadorit nga Presidenti i Republikës, Komisioni i Kuvendit që mbulon politikën e jashtme, organizon seancë dëgjimore me kandidatin për t'u emëruar ambasador.
3. Ministri i Punëve të Jashtme mund t'i besojë drejtimin e misionit diplomatik të ngarkuarit me punë, kur kjo çmohet e nevojshme për shkak të rrethanave.
4. Posti konsullor drejtohet nga konsulli i përgjithshëm, konsulli, zëvendëskonsulli ose agjenti konsullor.
5. Konsulli i përgjithshëm emërohet nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme.

Neni 22

Përzgjedhja e shefave të përfaqësive diplomatike

1. Shefat e përfaqësive diplomatike përzgjidhen ndërmjet diplomatëve të karrierës.
2. Në këto poste mund të emërohen edhe ish-anëtarë të Këshillit të Ministrave, ish-deputetë, personalitete të fushave të ndryshme, të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuara në këtë ligj.
3. Numri i personave të emëruar, sipas pikës 2 të këtij neni, nuk duhet të jetë më i lartë se 20 për qind e numrit të diplomatëve, që punojnë në përfaqësitë diplomatike me të njëjtin funksion. Këta persona bëjnë pjesë në shërbimin e jashtëm për aq kohë sa ushtrojnë funksionet në të cilat janë emëruar.

Neni 23

Funksionet e shefit të misionit diplomatik

1. Shefi i misionit diplomatik, në përputhje me Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike të vitit 1961, ushtron këto funksione kryesore:

a) përfaqëson dhe vepron në emër të Republikës së Shqipërisë në shtetin pritës ose organizatat ndërkombëtare;

b) inicion dhe nënshkruan instrumente diplomatike;

c) jep deklarata dhe mban qëndrime në emër të Republikës së Shqipërisë.

2. Shefi i misionit ka autoritet mbi të gjitha shërbimet, civile dhe ushtarake, që ushtrojnë veprimtarinë në misionin diplomatik. Ai drejton, udhëzon, kontrollon dhe vlerëson të gjithë veprimtarinë zyrtare të personelit të misionit diplomatik, si dhe kryen veprimtari të tjera, sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe të akteve të tjera nënligjore.

3. Shefi i misionit përgjigjet drejtpërdrejt përpara Ministrit të Punëve të Jashtme për zbatimin e politikës së jashtme të Republikës së Shqipërisë në shtetin pritës dhe vepron në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë e dhëna nga ky ligj, si dhe me drejtimit e udhëzimet e dhëna nga strukturat përkatëse në Ministrinë e Punëve të Jashtme.

4. Shefi i misionit bashkërendon dhe kontrollon veprimtarinë e posteve konsullore të Republikës së Shqipërisë në shtetin pritës.

Neni 24

Akreditimi në disa vende

1. Një ambasador në një shtet mund të akreditohet edhe në një ose disa shtete të tjera, pavarësisht nëse ka mision diplomatik ose post konsullor në këto shtete.

2. Shefi i misionit diplomatik dhe diplomatët e tjerë, të akredituar në disa shtete në të njëjtën kohë, kryejnë në shtetet e tjera të njëjtat funksione, që kryejnë në shtetin ku janë rezidentë.

3. Në shtetet ku nuk ka përfaqësi diplomatike, mund të emërohen si ambasadorë jorezidentë diplomatët me gradën ambasador, që punojnë në Ministrinë e Punëve të Jashtme. Ata kryejnë të njëjtat funksione përfaqësimi si ambasadorët rezidentë.

PJESA E TRETË

NËPUNËSIT E SHËRBIMIT TË JASHTËM

KREU I

STATUSI I NËPUNËSIT TË SHËRBIMIT TË JASHTËM

Neni 25

Kategorizimi i nëpunësve

1. Veprimtaria diplomatike në shërbimin e jashtëm kryhet nga diplomatët e karrierës dhe personat e tjerë të barazuar me ta, të cilët marrin funksione diplomatike, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

2. Në ushtrimin e funksioneve, ata ndihmohen nga personeli administrativ dhe teknik.

Neni 26

Diplomatët

Diplomati merr funksione dhe kryen detyra në shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me Kushtetutën, me dispozitat e këtij ligji dhe me aktet e tjera ligjore në fuqi.

Neni 27

Kërkesat për pranimin në shërbimin e jashtëm

Në shërbimin e jashtëm pranohen personat, të cilët plotësojnë, veçanërisht, këto kërkesa:

- a) të kenë shtetësi shqiptare dhe banim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë;
- b) të kenë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) të mos jenë dënuar për kryerjen e një vepre penale;
- ç) të mos jetë marrë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga puna nga administrata publike;
- d) të jenë në kushte të mira shëndetësore për të kryer detyrën;
- dh) të kenë përfunduar studimet e larta në një institucion arsimor, brenda ose jashtë vendit, të njohur nga shteti;
- e) të zotërojnë gjuhë të huaj të pranueshme dhe të përshtatshme për punën në shërbimin e jashtëm.

Neni 28

Pranimi

Pranimi në shërbimin e jashtëm bëhet nëpërmjet konkurrimit të hapur, në përputhje me ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil". Gjithashtu, periudha e provës së nëpunësit u nënshtrohet kriterëve dhe procedurave të parashikuara në këtë ligj.

Neni 29

Transferimi, lëvizja paralele, ngritja në detyrë

1. Transferimi, lëvizja paralele dhe ngritja në detyrë e nëpunësit, brenda shërbimit të jashtëm, bëhen me urdhër të Ministrit të Punëve të Jashtme, në bazë të propozimit të Sekretarit të Përgjithshëm dhe njoftimit të Departamentit të Administratës Publike. Në çdo rast, propozimi shoqërohet dhe mbështetet në vlerësimin e punës, të paraqitur nga eprori direkt i nëpunësit.

2. Procedurat e kryerjes së transferimit, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë përcaktohen në Rregulloren për Shërbimin e Jashtëm.

Neni 30

Emërimi në përfaqësitë diplomatike

1. Diplomatat emërohen në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Shqipërisë, të akredituara në shtete të tjera, të paktën dy vjet pasi kanë marrë gradën e parë diplomatike (atashe). Ata qëndrojnë me shërbim në të njëjtën përfaqësi diplomatike, si rregull, për një periudhë 4-vjeçare.

2. Procedurat e emërimit në përfaqësitë diplomatike përcaktohen në Rregulloren për Shërbimin e Jashtëm.

Neni 31

Kthimi ose tërheqja e parakohshme nga përfaqësitë diplomatike

1. Ministri i Punëve të Jashtme urdhëron kthimin ose tërheqjen e një diplomati nga përfaqësia diplomatike, përpara mbarimit të afatit të caktuar, për arsyt e mëposhtme:

- a) për nevoja pune në Ministrinë e Punëve të Jashtme;
- b) në bazë të kërkesës së vetë diplomatit;
- c) për arsye të vlerësimit negativ të punës së diplomatit;
- ç) për shkelje të dispozitave të këtij ligji ose të akteve të tjera në fuqi;
- d) kur një gjë e tillë kërkohet nga shteti pritës.

2. Tërheqja e parakohshme e shefit të përfaqësisë diplomatike kryhet sipas procedurës së përcaktuar në nenin 21 të këtij ligji.

Neni 32

Pezullimi i nëpunësit të shërbimit të jashtëm

1. Nëpunësi i shërbimit të jashtëm pezullohet nga ushtrimi i funksioneve të tij:
 - a) kur ndaj tij fillon procedimi penal për vepra penale, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar;
 - b) për periudha studimi, më shumë se 6 muaj, të ndërmarra me nismën e vetë nëpunësit, por me miratimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, të cilat kanë lidhje me profesionin që ai ushtron.
2. Gjatë periudhës së pezullimit, nëpunësi i shërbimit të jashtëm nuk paguhet.
3. Në rastin e parashikuar në shkronjën "a" të pikës 1 të këtij neni, kur çështja penale pushohet ose kur me vendim gjyqësor të formës së prerë deklarohet i pafajshëm, nëpunësi rikthehet në shërbimin e jashtëm dhe, njëkohësisht, rifiton statusin, pagën dhe çdo të drejtë tjetër, që nga çasti i pezullimit.
4. Për rastin e parashikuar në shkronjën "b" të pikës 1 të këtij neni, periudha e pezullimit merret në konsideratë për efekt të llogaritjes së afatit kohor, të nevojshëm për përfitimin e gradave diplomatike.

Neni 33

Humbja e statusit në shërbimin e jashtëm

- Nëpunësi i shërbimit të jashtëm humbet statusin në këtë shërbim kur:
- a) largohet në mënyrë vullnetare nga shërbimi i jashtëm;
 - b) për shkak të vdekjes së vetë nëpunësit;
 - c) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
 - ç) kryen shkelje të rënda, të parashikuara në Rregulloren për Shërbimin e Jashtëm, për të cilat ndaj tij merret masa e largimit nga puna.

Neni 34

Punësimi jashtë Ministrisë së Punëve të Jashtme

1. Një diplomat mund të punësohet në institucione të tjera të administratës shtetërore, për të kryer detyra drejtuese ose këshilluese në fushën e marrëdhënieve me jashtë, me miratimin e Ministrit të Punëve të Jashtme. Periudha e punësimit në këtë detyrë merret në konsideratë për efekt të llogaritjes së afatit kohor, të nevojshëm për përfitimin e gradave diplomatike.
2. Me mbarimin e detyrës në institucionin përkatës ose me kërkesë të tij, diplomati ka të drejtë të kthehet në shërbimin e jashtëm.

KREU II GRADAT

Neni 35

Gradat diplomatike dhe konsullore

1. Diplomatët e karrierës, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe në përfaqësitë diplomatike, marrin grada diplomatike ose konsullore.
2. Gradat diplomatike në shërbimin e jashtëm janë:
 - a) ambasador;
 - b) ministër fuqiplotë;
 - c) ministër këshilltar;
 - ç) këshilltar;
 - d) sekretar i parë ;
 - dh) sekretar i dytë;
 - e) sekretar i tretë;
 - ë) atashe.
3. Gradat konsullore në shërbimin e jashtëm janë:

- a) konsull i përgjithshëm;
- b) konsull;
- c) zëvendëskonsull;
- ç) agjent konsullor.

Neni 36

Barasvlera e gradave

Diplomatët mund të kalojnë nga një gradë diplomatike në një gradë konsullore, në përputhje me funksionet dhe detyrat e ngarkuara. Në çdo rast, kalimi bëhet duke respektuar barazvlerën e gradave, e cila është:

konsull i përgjithshëm	ministër këshilltar;
konsull	sekretar i parë ose i dytë;
zëvendëskonsullsekretar i dytë ose i tretë;	agjent konsullorsekretar i tretë ose atashe.

Neni 37

Dhënia e gradave

1. Nëpunësit e shërbimit të jashtëm, sipas sistemit të karrierës, gradohen duke i ngjitur shkallët një nga një. Elementet kryesore në dhënien e një grade për anëtarin e shërbimit të jashtëm janë koha e shërbimit, kualifikimi dhe vlerësimi i rezultateve të punës.

2. Gradat jepen nga Komisioni i Gradave dhe i Disiplinës, mbi bazën e të dhënave që ndodhen në dosjen personale të çdo punonjësi dhe në bazë të vlerësimeve të bëra, sipas kritereve dhe rregullave të përcaktuara në Rregulloren për Shërbimin e Jashtëm.

3. Grada diplomatike ambasador propozohet nga Ministri i Punëve të Jashtme, miratohet nga Kryeministri dhe dekretohet nga Presidenti i Republikës.

4. Nëpunësit e shërbimit të jashtëm, që përfitojnë gradën ambasador, duhet të jenë diplomatë karriere, të cilët kanë kaluar të gjitha shkallët e gradave, të përcaktuara sipas këtij ligji dhe që kanë qenë të emëruar në detyrën e shefit të misionit të paktën për një mandat.

Neni 38

Periudha për kalimin nga një gradë në tjetrën

1. Periudha minimale për kalimin e diplomatit nga një gradë në një tjetër më të lartë, pas përfundimit të periudhës së provës, është:

- a) nga atashe në sekretar i tretë, 2 vjet;
- b) nga sekretar i tretë në sekretar i dytë, 3 vjet;
- c) nga sekretar i dytë në sekretar i parë, 3 vjet;
- ç) nga sekretar i parë në këshilltar, 4 vjet;

2. Kriteret për përfitimin e gradës ministër këshilltar dhe ministër fuqiplotë përcaktohen në Rregulloren për Shërbimin e Jashtëm.

PJESA E KATËRT TË DREJTAT DHE DETYRAT E NËPUNËSIT TË SHËRBIMIT TË JASHTËM

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 39

Të drejtat

Nëpunësi i shërbimit të jashtëm ka të drejtë:

- a) të gëzojë statusin e diplomatit;
- b) të përfitojë gradë në shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë;
- c) të mbajë funksione në Ministrinë e Punëve të Jashtme ose në përfaqësitë diplomatike, në përputhje me nivelin profesional dhe gradën që gëzon;
- ç) të përfitojë nga imunitetet dhe lehtësitë, që i jep statusi i diplomatit, në përputhje me aktet dhe të drejtën ndërkombëtare në periudhën kur ndodhet me shërbim jashtë shtetit;
- d) të përfitojë nga kualifikimet dhe trajnimet e kryera nga Ministria e Punëve të Jashtme;
- dh) të përfitojë trajtim financiar të posaçëm, në përputhje me statusin e tij;
- e) të gëzojë të gjitha të drejtat e tjera, të njohura në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 40

Detyrat

Nëpunësi i shërbimit të jashtëm ka për detyrë:

- a) të ushtrojë me ndershmëri dhe korrektësi funksionet dhe detyrat e ngarkuara, në përputhje me urdhrat, udhëzimet e rregulloret e Ministrit të Punëve të Jashtme, aktet ndërkombëtare dhe me legjislacionin shqiptar;
- b) të mbajë përgjegjësi të plotë për ligjshmërinë e veprimeve gjatë kryerjes së detyrës dhe, kur nuk është i bindur për ligjshmërinë e urdhrave dhe të vendimeve që zbaton, të njoftojë nivelet urdhërdhënëse dhe nivelet eprorë të këtyre të fundit;
- c) të mbrojë interesat e shtetit dhe të shtetasve ose personave juridikë shqiptarë në shtetin ose shtetet, ku është akredituar dhe kryen funksionet e tij;
- ç) të zbatojë rregullat për informacionin e klasifikuar edhe pas largimit nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe të sigurojë ruajtjen e të dhënave dhe të informatave që i janë besuar;
- d) të mos bëjë pjesë në asnjë parti, organizatë ose shoqatë politike;
- dh) të mbajë, në të gjitha rrethanat, një qëndrim moral të denjë dhe të paqortueshëm;
- e) të mos bëjë deklarata që mund të vënë në pozitë të vështirë shtetin shqiptar në marrëdhënie me shtetet e tjera ose organizatat ndërkombëtare dhe që mund të krijojnë probleme në realizimin e politikës së jashtme të Republikës së Shqipërisë;
- ë) të respektojë ligjet e shtetit ose të shteteve, ku është akredituar, dhe të mos përfshihet në veprimtari, të cilat mund të vlerësohen si ndërhyrje në punët e brendshme të shtetit ose të shteteve ku zhvillon veprimtarinë;
- f) të ushtrojë veprimtarinë e vet në përputhje me imunitetet dhe privilegjet që gëzon si anëtar i trupit diplomatik;
- g) të mos ushtrojë në shtetin ose shtetet, ku është akredituar, veprimtari tregtare ose çdo veprimtari tjetër fitimprurëse për llogari të tij ose të të afërmeve të tij.

Neni 41

Komisioni i Gradave dhe i Disiplinës

1. Komisioni i Gradave dhe i Disiplinës ka për detyrë:

- a) dhënien e gradave diplomatike për nëpunësit e shërbimit të jashtëm;
- b) shqyrtimin e ankesave të nëpunësve të shërbimit të jashtëm, ndaj të cilëve është marrë masë disiplinore nga eprori direkt i tyre;
- c) shqyrtimin e rasteve të shkeljeve të rënda, të kryera nga nëpunësit e shërbimit të jashtëm dhe propozimin te Ministri i Punëve të Jashtme i masave disiplinore për nëpunësit, që kanë kryer këto shkelje.

2. Komisioni i Gradave dhe i Disiplinës përbëhet nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme, Drejtori i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe tre diplomatë me gradën më të lartë.

3. Mënyra e funksionimit dhe kompetencat e Komisionit të Gradave dhe të Disiplinës përcaktohen në Rregulloren për Shërbimin e Jashtëm.

KREU II
SHKELJET DHE MASAT DISIPLINORE

Neni 42

Përgjegjësia disiplinore

Nëpunësi i shërbimit të jashtëm përgjigjet për shkeljet e kryera gjatë ushtrimit të funksionit dhe realizimit të detyrave të ngarkuara. Shkalla e përgjegjësisë lidhet me llojin e shkeljes së kryer dhe pasojat e ardhura.

Neni 43

Llojet e shkeljeve

1. Për nëpunësin e shërbimit të jashtëm vlerësohen, veçanërisht, si shkelje:
 - a) veprimet ose mosveprimet, të cilat cenojnë imazhin e Republikës së Shqipërisë dhe të shërbimit të jashtëm;
 - b) moskryerja e detyrave të ngarkuara pa shkaqe të arsyeshme;
 - c) veprimet që cenojnë figurën etiko-morale të nëpunësit të shërbimit të jashtëm;
 - ç) dëmtimi i pasurisë shtetërore ose krijimi i mundësive për një dëmtim të tillë;
 - d) shkelja e akteve ligjore e nënligjore në tërësi dhe atyre që rregullojnë veprimtarinë e shërbimit të jashtëm, në veçanti.
2. Kategorizimi i shkeljeve të kryera nga nëpunësi i shërbimit të jashtëm përcaktohet në Rregulloren për Shërbimin e Jashtëm.

Neni 44

Masat disiplinore

1. Për shkeljet e kryera nga nëpunësi i shërbimit të jashtëm, gjatë ushtrimit ose në funksion të detyrës, ndaj tij merren masa disiplinore. Procedura e shqyrtimit të shkeljes dhe e dhënies së masës disiplinore garanton të drejtën e informimit, dëgjimit dhe të mbrojtjes.
2. Për shkeljet e lehta të kryera nga nëpunësi i shërbimit të jashtëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme, masa disiplinore jepet nga eprori direkt, kurse për nëpunësin e përfaqësisë diplomatike masa disiplinore jepet nga shefi i përfaqësisë diplomatike. Për shkeljet e rënda, masa disiplinore jepet nga Ministri i Punëve të Jashtme, në bazë të propozimit të Komisionit të Gradave dhe të Disiplinës.
3. Për masat disiplinore të marra ndaj tij, nëpunësi i shërbimit të jashtëm ka të drejtë të ankohet pranë Komisionit të Shërbimit Civil, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin nr.8548, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil".
4. Llojet e masave disiplinore dhe procedura për dhënien e tyre përcaktohen në Rregulloren për Shërbimin e Jashtëm.

PJESA E PESTË
TRAJTIMI FINANCIAR I PUNONJËSVE
TË SHËRBIMIT TË JASHTËM

Neni 45

Pagat e punonjësve të shërbimit të jashtëm

1. Pagat e punonjësve të shërbimit të jashtëm caktohen në bazë të funksionit, gradave dhe vjetërsisë në punë.
2. Pagat caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 46

Trajtimi i familjeve të personelit të përfaqësive diplomatike

1. Për personelin e përfaqësive diplomatike, koha e qëndrimit jashtë shtetit i njihet për efekt të vjetërsisë në punë dhe të pagesës së kontributit të sigurimeve, shoqërore dhe shëndetësore, edhe bashkëshortit/es, i/e cili/a shoqëron nëpunësin në përfaqësinë diplomatike.

Fëmijët e personelit të përfaqësive diplomatike përfitojnë sigurimet shëndetësore, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

2. Bashkeshorti/ja, që në kohën e emërimit të diplomatit jashtë shtetit ka punuar në një institucion shtetëror, ka të drejtë të kthehet në këtë vend pune pas kthimit të bashkëshortit/es në atdhe. Institucioni shtetëror ku bashkeshorti/ja ka qenë i/e punësuar, ka detyrimin ta rimarrë në të njëjtin pozicion pune ose në një pozicion të barasvlefshëm.

3. Ministria e Punëve të Jashtme garanton arsimimin tetëvjeçar dhe të mesëm të fëmijëve të personelit, të emëruar në përfaqësinë diplomatike dhe kur është e nevojshme, siguron financimin e këtij arsimimi. Mënyra, kriteret dhe kushtet e financimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

PJESA E GJASHTË

NËPUNËSIT ADMINISTRATIVË DHE PERSONELI NDIHMËS

Neni 47

Statusi i nëpunësve administrativë dhe i personelit ndihmës

1. Nëpunës administrativë në shërbimin e jashtëm quhen nëpunësit, të cilët kryejnë detyra në sektorët e llogarisë dhe të financës, në fushën e përpunimit të të dhënave dhe në çështje administrative. Për këta nëpunës zbatohen dispozitat e ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil" dhe të akteve të tjera nënligjore në zbatim të tij.

2. Personel ndihmës në shërbimin e jashtëm quhet ajo kategori punonjësish, të cilët kryejnë detyra në sektorët ndihmës, të mirëmbajtjes dhe të shërbimit. Për këtë kategori punonjësish zbatohen dispozitat e Kodit të Punës.

Neni 48

Rekrutimi i stafit vendor

Përfaqësitë diplomatike mund të punësojnë shtetas të shtetit pritës, sipas procedurave të parashikuara në Rregulloren për Shërbimin e Jashtëm, për kryerjen e punëve administrativo-teknike dhe të shërbimit.

PJESA E SHTATË DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 49

Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 5 pika 2, 12 pika 2, 13, 45 pika 2 dhe 46 pika 3 të këtij ligji.

2. Ministria e Punëve të Jashtme, brenda 3 muajve nga miratimi i këtij ligji, përgatit Rregulloren për Shërbimin e Jashtëm. Rregullorja miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 50

Shfuqizime

Ligji nr.8370, datë 9.7.1998 "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", shfuqizohet.

Neni 51
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3909, datë 30.7.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

L I G J
Nr.9096, datë 3.7.2003

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8308, DATË 18.3.1998 "PËR
TRANSPORTET RRUGORE", NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.8908, DATË 6.6.2002**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8308, datë 18.3.1998 "Për transportet rrugore", ndryshuar me ligjin nr.8908, datë 6.6.2002, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 3:

1. Pika 3.7 ndryshohet si më poshtë:

"3.7. Kamion: mjet i destinuar për transportin e mallrave dhe të njerëzve, të caktuar për përpunimin ose transportin e këtyre mallrave."

2. Pika 3.8 ndryshohet si më poshtë:

"3.8. Tërheqës: mjet i destinuar për tërheqjen vetëm të rimorkiove ose të gjysmërimorkiove."

3. Pika 3.10 ndryshohet si më poshtë:

"3.10. Transport i rregullt udhëtarësh është shërbim i rregullt transporti në itinerare dhe vendqëndrime të pandryshuara, të ofruara nga transportuesi dhe të përcaktuara më parë në rregulloren e udhëtimit. Ky shërbim mund të jetë qytetës, rrethqytetës, ndërqytetës, ndërkombëtar dhe shërbim i rregullt, i specializuar."

4. Pika 3.11 ndryshohet si më poshtë:

"3.11. Transport i rastit i udhëtarëve nënkupton shërbimet që nuk përfshihen në shërbimet e rregullta brenda vendit ose ato ndërkombëtare, të përkufizuara në pikën 3.10 të nenit 3, të cilat kryhen në itinerarin, me çmimin, shkallën e shërbimit dhe kushtet e tjera, që përcaktohen në marrëveshjen ndërmjet transportuesit dhe përdoruesit."

5. Pika 3.13 ndryshohet si më poshtë:

"3.13. Transport për vete: transporti i mallrave me kamion, në ardhje ose në kthim, vetëm për llogari të veprimtarisë së vet. Në këtë rast transporti është vetëm një veprimtari ndihmëse e veprimtarisë kryesore, e cila vërtetohet sipas ligjeve në fuqi."

6. Pika 3.16 ndryshohet si më poshtë:

"3.16. Organe transporti janë organet dhe zyrat që merren me transportin në ministri e organet në varësi të saj, si dhe zyrat në qark, bashki dhe komunë."

7. Shkronja "b" e pikës 3.18 ndryshohet si më poshtë:

"b) dokument që i jep të drejtë një mjetei vetëm për transportin e mallrave për vete brenda dhe

jashtë vendit, në përputhje me pikën 3.13 të këtij ligji.”.

Neni 2

Në kreun II.1 titulli "TRANSPORTI ME AUTOBUS BRENDA VENDIT", zëvendësohet me "TRANSPORTI I UDHËTARËVE BRENDA VENDIT".

Neni 3

Neni 12 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 12

Transporti i udhëtarëve brenda vendit kryhet nëpërmjet:

- a) shërbimeve në linja të rregullta, transporti qytetës, rrethqytetës dhe ndërqytetës;
- b) shërbimeve të rregullta, të specializuara;
- c) transporteve për llogari të vet;
- ç) transporteve të rastit.”.

Neni 4

Neni 14 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 14

Këshilli bashkiak, duke u mbështetur në nevojat e popullsisë për transportin qytetës, përcakton linjat, organizon, financon dhe vendos për këtë lloj transporti brenda juridiksionit të vet.

Transporti qytetës kryhet me autobus vetëm nga shoqëritë, të cilat kanë të shprehur në aktet e themelimit, si objekt të veprimtarisë, veprimtarinë e transportit të udhëtarëve.

Licenca për transportin qytetës jepet nga kryetari i bashkisë.”.

Neni 5

Neni 15 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 15

Transporti rrethqytetës kryhet nga subjekte juridike të organizuara në shoqëri transporti dhe në raste të kufizuara edhe nga persona fizikë, ndërmjet:

- a) bashkive brenda të njëjtit rreth;
- b) qendrës së komunës në drejtim të qytetit të të njëjtit rreth dhe anasjelltas;
- c) qendrave të komunave të një rrethi (pa lejim kalimi në qytet);
- ç) qendrave të banuara të një komune në drejtim të qendrës së komunës dhe/ose të një komune tjetër dhe anasjelltas;
- d) qendrave të banuara të një komune.

Licenca për këtë lloj transporti jepet nga kryetari i bashkisë dhe i komunës, ku ka selinë subjekti.”.

Neni 6

Neni 16 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 16

Transporti ndërqytetës është shërbimi, që plotëson nevojat e lëvizjes së popullsisë ndërmjet:

- a) bashkive qendër të rretheve të ndryshme brenda një qarku;

- b) bashkive qendër të rretheve për qarqe të ndryshme;
- c) bashkisë joqendër rrethi me qendër rrethi të qarqeve të ndryshme;
- ç) bashkive qendër të rretheve me stacionet hekurudhore, skajore, për vazhdimin e udhëtimit, duke ndryshuar llojin e transportit, aeroportin dhe bankinën liqenore.

Ky lloj transporti kryhet nga persona juridikë, të organizuar në shoqëri transporti e të pajisur me licencë."

Neni 7

Neni 17 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 17

Transporti ndërqytetës, rrethqytetës dhe ai qytetës i udhëtarëve, si shërbim i rregullt, kryhet nga shoqëritë ose nga personat fizikë, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, brenda afatit të përcaktuar në licencë.

Për të fituar të drejtën si shoqëri e vetme në një apo disa linja të rregullta, kjo shoqëri transporti duhet të ketë numrin e autobusëve, në përputhje me nevojat e linjës.

Kushtet dhe rregullat për marrjen e licencës dhe të së drejtës si e vetme shoqëri transporti në një ose disa linja të rregullta përcaktohen me udhëzim të ministrit."

Neni 8

Neni 19 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 19

a) Rrjeti i linjave ndërqytetëse brenda një qarku dhe oraret e tyre miratohen nga këshilli i qarkut. Licenca për këto linja jepet nga kryetari i këshillit të qarkut.

b) Rrjeti i linjave ndërqytetëse ndërmjet qarqeve të ndryshme dhe oraret e tyre miratohen me urdhër të ministrit, i cili jep dhe licencën për këto linja.

c) Për rastet e tjera, të përcaktuara në shkronjën "c" të nenit 16, linjat miratohen me urdhër të ministrit, me propozimin e këshillit të qarkut. Ministri përcakton institucionin, i cili jep licencën për këto linja."

Neni 9

Neni 20 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 20

Rrjeti i linjave rrethqytetëse dhe oraret e tyre miratohen nga këshilli i qarkut."

Neni 10

Neni 23 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 23

Në raste fatkeqësish natyrore ose në raste të gjendjes së jashtëzakonshme, për plotësimin e nevojave të transportit, ministria dhe organet e njësisë të qeverisjes vendore, me urdhër, lejojnë përkohësisht ushtrimin e veprimtarisë së transportit jashtë linjave të miratuara më parë."

Neni 11

Pas nenit 23 shtohen nenet 23/1 dhe 23/2 si më poshtë:

"Neni 23/1

Janë, gjithashtu, shërbime të rregullta ato shërbime, që sigurojnë një transportim për kategori të caktuara udhëtarësh, duke përjashtuar udhëtarët e tjerë, përderisa shërbime të tilla kryhen në përputhje me kushtet e përcaktuara në pikën 3.10 të nenit 3.

Shërbimet e rregullta të specializuara janë shërbime, të cilat përfshijnë:

- a) transportin shtëpi-punë të punonjësve;
- b) transportin shtëpi-institucion shkollor të nxënësve dhe studentëve;
- c) transportet qytetëse kufitare, kur lejohen me marrëveshje ndërkombëtare.

Shërbimet e rregullta të specializuara kryhen me autobus.

Për shërbimet sipas shkronjave "a" dhe "b", dokumentacioni shoqërues i automjetit përcaktohet me udhëzim të ministrit.

Për shërbimet sipas shkronjës "c" jepet licencë nga ministri, i cili përcakton, me udhëzim, kushtet dhe rregullat për marrjen e kësaj licence.

Neni 23/2

Transporte për llogari të vet quhen transportet e kryera nga një ndërmarrje për punonjësit ose nga një shoqatë, pa qëllim fitimi, për anëtarët e vet, në kuadër të veprimtarisë shoqërore, me kusht që:

- a) transporti të përbëjë vetëm një veprimtari ndihmëse për ndërmarrjen ose shoqatën;
- b) mjetet e përdorura të jenë pronë e ndërmarrjes ose e shoqatës, të jenë blerë me këste nga këto të fundit ose të jenë objekt i një kontrate qiraje afatgjatë dhe të drejtohen nga një punonjës i ndërmarrjes ose anëtar i shoqatës.

Dokumentacioni, që shoqëron automjetin, për transportin për llogari të vet, përcaktohet me udhëzim të ministrit."

Neni 12

Në kreun II.2 titulli "TRANSPORTI I LIRË ME AUTOBUSË" zëvendësohet me "TRANSPORTET E RASTIT ME AUTOBUSË"

Neni 13

Neni 25 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 25

Transportet e rastit, sipas përcaktimit të bërë në pikën 3.11 të nenit 3, janë objekt i këtij ligji."

Neni 14

Neni 26 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 26

Transportet e rastit janë shërbime që kryhen me autobus dhe përfshijnë:

- a) udhëtimet me dyer të mbyllura, domethënë shërbimet e kryera me të njëjtin mjet që transporton një ose më shumë grupe udhëtarësh të formuar më parë, duke e kthyer çdo grup në vendin e nisjes;
- b) shërbimet:

- i) e kryera për grupe udhëtarësh të formuara më parë, pa kthimin e udhëtarëve në vendin e

nisjes gjatë të njëjtit udhëtim dhe kthimin bosh të mjetit në vendin e nisjes;

ii) e kryera me mjet bosh në vajtje në vendin e destinacionit, për grupe udhëtarësh të formuara më parë, me kthimin e mjetit me udhëtarë në vendin e nisjes;

c) shërbimet e organizuara me rastin e ngjarjeve të veçanta, si konferenca, seminare ose manifestime kulturore-sportive, që nuk u përgjigjen përkufizimeve të shkronjave "a" dhe "b".

Grup i formuar më parë do të quajmë një grup:

a) për të cilin një organizëm ose një person përgjegjës është ngarkuar të marrë masa për nënshkrimin e kontratës ose për pagesën kolektive të shërbimit apo për marrjen e të gjitha prenotimeve dhe të pagesave përpara nisjes;

b) që është formuar nga një numër personash:

i) jo më pak se 12 veta;

ii) jo më pak se 40 për qind e kapacitetit të mjetit, pa llogaritur shoferin."

Neni 15

Neni 27 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 27

Transporti turistik, i cili bën pjesë në transportet e rastit, është, gjithashtu, objekt i këtij ligji.

Agjencitë turistike, për kryerjen e veprimtarisë së tyre, kanë të drejtë të marrin autobusë me qira, sipas kontratës me persona fizikë a juridikë."

Neni 16

Neni 28 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 28

Dokumentacioni, me të cilin duhet të jetë i pajisur autobusi në transportet e rastit, caktohet me udhëzim të ministrit."

Neni 17

Neni 29 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 29

Transporti rrugor ndërkombëtar i udhëtarëve me autobus kryhet në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe me marrëveshjet ndërkombëtare, të nënshkruara nga Republika e Shqipërisë.

Transporti rrugor ndërkombëtar i udhëtarëve kryhet nëpërmjet:

1. shërbimeve të rregullta;

2. shërbimeve të rregullta, të specializuara;

3. shërbimeve vajtje-ardhje.

Me "shërbime vajtje-ardhje" kuptohen shërbimet, që organizohen për të transportuar grupe udhëtarësh të formuara më parë nga e njëjta zonë nisjeje dhe me të njëjtën zonë mbërritjeje, me udhëtime të përsëritura vajtje dhe ardhje. Të tilla grupe, të përbëra nga udhëtarë që kanë kryer udhëtimin e vajtjes, rikthehen në zonën e nisjes me anën e një udhëtimi pasues, ku:

a) asnjë udhëtar nuk mund të merret ose të zbret gjatë udhëtimit;

b) udhëtimi i parë në ardhje dhe i fundit në vajtje në një sërë udhëtimesh vajtje-ardhje bëhet bosh;

4. shërbimeve të rastit.

Përveç shërbimeve vajtje-ardhje, përkufizimet e shërbimeve të transportit rrugor ndërkombëtar përkojnë respektivisht me nenin 3 pikat 3.10 dhe 3.11 të këtij ligji.

Në rast se nuk janë përfunduar marrëveshje me shtete të veçanta, transporti rrugor ndërkombëtar me autobus kryhet në përputhje me këtë ligj dhe rregullat e përcaktuara në aktet përkatëse të organizmave ndërkombëtarë, në të cilët Republika e Shqipërisë ka aderuar."

Neni 18

Në kreun II.4 titulli "TRANSPORTI ME TAKSI" zëvendësohet me "TRANSPORTI I UDHËTARËVE ME TAKSI".

Neni 19

Neni 35 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 35

Numri i taksive, për çdo qark, përcaktohet nga ministri në shkallë vendi.

Këshilli i qarkut, me vendim, përcakton numrin maksimal të taksive për bashkitë dhe komunat në territorin e vet.

Këshilli bashkiak a komunal, me vendim, përcaktojnë mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të këtij shërbimi brenda juridiksionit të vet.

Licenca për shërbimin taksi jepet nga kryetari i bashkisë ose kryetari i komunës përkatëse."

Neni 20

Neni 36 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 36

Rregullat dhe kushtet për kërkesa të veçanta për taksitë, si dhe për zbatimin e tarifave dhe të çmimeve, përcaktohen me udhëzim të ministrit.

Këshilli i qarkut përcakton, në përputhje me udhëzimet e ministrit, nivelet e diferencuara të çmimeve dhe tarifave brenda juridiksionit të vet.

Niveli dysheme i tarifave të shërbimit taksi, për të gjitha llojet e taksive, nuk mund të jetë më pak se dyfishi i çmimeve të shërbimeve të njëjta me autobus (për shërbimet në linja të rregullta, qytetëse, rrethqytetëse dhe ndërqytetëse)."

Neni 21

Neni 68 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 68

Shkeljet e dispozitave të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë e me masë plotësuese të pezullimit të lejes së transportit (ose të certifikatës) dhe të lejes së qarkullimit.

Për shkelje të dispozitave të parashikuara në nenet:

a) 5, 11, 23/1 shkronjat "a" dhe "b", 23/2, 30, 31 dhe 38 dënohen me gjobë nga 5 000 deri në 100 000 lekë dhe me masën plotësuese të pezullimit të lejes së qarkullimit nga 1 deri në 3 muaj;

b) 10 shkronja "b", 21, 23/1 shkronja "c", 25, 26, 27, 28, 36 paragrafi i tretë dhe 37 dënohen me gjobë nga 50 000 deri në 200 000 lekë, si dhe me masën plotësuese të pezullimit të lejes së transportit ose të certifikatës nga 3 deri në 6 muaj.

c) 54 shkronja "c", 56, 57, 60 dhe 61 dënohen me gjobë nga 50 000 deri në 200 000 lekë, si dhe me masën plotësuese të pezullimit të lejes së transportit ose të certifikatës nga 3 deri në 6 muaj."

Neni 22

Neni 69 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 69

Gjashtëdhjetë për qind e të ardhurave nga të gjitha gjobat, për shkeljet e parashikuara nga ky ligj, i kalojnë organit që konstaton shkeljen, i cili i përdor për përmirësimin e shërbimit në zbatim të këtij ligji, kurse dyzet për qind e të ardhurave i kalojnë Buxhetit të Shtetit."

Neni 23

Neni 71 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 71

Për shkeljet, të cilat nuk janë parashikuar në nenin 68 të këtij ligji, organet e kontrollit në rrugë kanë të drejtë të gjobisin në vend kundërvajtësit me gjobë nga 250 deri në 5 000 lekë.

Masa e gjobës dokumentohet me procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i jepet detyrimit kundërvajtësit."

Neni 24

Neni 74 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 74

Kur organet e policisë rrugore, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, konstatojnë shkelje të këtij ligji, bashkëpunojnë me organet e specializuara për kontrollin dhe mbikëqyrjen e transportit dhe marrin masat përkatëse, sipas kompetencave që ka ky organ."

Neni 25

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3910, datë 30.7.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

L I G J
Nr.9097, datë 3.7.2003

PËR VLERËSIMIN E KONFORMITETIT

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

K R E U I
PËRCAKTIME TË PËRGJITHSHME DHE PËRKUFIZIME

Neni 1

Qëllimi i këtij ligji është të vendosë parimet e përgjithshme për përcaktimin e procedurave të njëjta për vlerësimin e konformitetit të produkteve, proceseve ose shërbimeve në sferën e detyruar. Për të gjitha produktet, proceset ose shërbimet, që nuk përfshihen në sferën e detyruar, vlerësimi i konformitetit është vullnetar.

Neni 2

Ky ligj zbatohet nga çdo person fizik dhe juridik, publik ose privat, vendas a i huaj, që deklaron vlerësimin e konformitetit të produkteve, proceseve ose shërbimeve, përkundrejt kërkesave të standardeve, rregullave teknike ose kërkesave të tjera teknike apo akteve ligjore në fuqi.

Neni 3

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “konformitet” është plotësimi nga një produkt, proces ose shërbim i kërkesave të specifikuara;

b) “vlerësim i konformitetit” është çdo veprimtari, e drejtpërdrejtë a e tërthortë, që përcakton nëse është plotësuar tërësia e kërkesave teknike, të vendosura në dokumentacionin përkatës;

c) “sferë e detyruar e vlerësimit të konformitetit (objektiv legjitim)” është veprimtaria e subjektit të vlerësimit të detyruar të konformitetit të produkteve, proceseve ose shërbimeve, që kanë të bëjnë me sigurinë e jetës, mbrojtjen e shëndetit dhe të mjedisit ose me interesa të tjerë publikë;

ç) “sferë vullnetare e vlerësimit të konformitetit” është subjekti vullnetar i vlerësimit të konformitetit të produkteve, proceseve ose shërbimeve, që nuk kanë të bëjnë me sigurinë e jetës, mbrojtjen e shëndetit të mjedisit ose me interesa të tjerë publikë;

d) “autorizim” është dhënia e së drejtës organizmave publikë ose privatë nga ministritë ose institucionet e tjera qendrore, të fushës përkatëse, për të kryer vlerësimin e konformitetit të produkteve, proceseve ose të shërbimeve në sferën e detyruar;

dh) “organizëm për vlerësimin e konformitetit në sferën e detyruar” është organizmi, publik ose privat, i propozuar nga ministria a institucioni tjetër qendror përkatës, i miratuar nga Këshilli i Ministrave;

e) “palë” është organizmi i autorizuar për vlerësimin e konformitetit në sferën e detyruar të produktit, procesit ose shërbimit, nga njëra anë, dhe prodhuesit e shpërndarësit, nga ana tjetër, të cilët i nënshtrohen këtij vlerësimi.

KREU II

VLERËSIMI I KONFORMITETIT NË SFERËN E DETYRUAR

Neni 4

1. Vlerësimi i konformitetit në sferën e detyruar zbatohet për produktet, proceset ose shërbimet, që kanë të bëjnë me sigurinë e jetës, mbrojtjen e shëndetit dhe të mjedisit apo të interesave të tjerë publikë.

2. Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore detyrohen të hartojnë, të miratojnë dhe të ndjekin zbatimin e rregullave teknike në sferën e detyruar, në të gjitha fushat e veprimtarisë që mbulojnë.

3. Nuk është objekt i këtij ligji vlerësimi i konformitetit në sferën e detyruar për produktet e industrisë ushqimore, për ushqimet për kafshët dhe për prodhimet farmaceutike e produktet bujqësore, si bimë, fidanë etj.

Neni 5

Vlerësimi i konformitetit në sferën e detyruar bëhet nga organizma publikë ose privatë, të propozuar nga ministria apo institucioni qendror përkatës, të miratuar nga Këshilli i Ministrave. Këta

organizma, në këtë rast, marrin përgjegjësi të plotë tekniko-financiare për veprimtarinë që kryejnë.

Neni 6

1. Procedurat përkatëse të vlerësimit të konformitetit në sferën e detyruar përcaktohen drejtpërdrejt në rregullat teknike ose, në mënyrë të tërthortë, në standarde a kërkesa teknike.

2. Mbikëqyrja e zbatimit të kërkesave teknike bëhet nga ministria ose institucioni qendror i ngarkuar me këtë detyrë.

Neni 7

Këshilli i Ministrave ka të drejtë të autorizojë organizmat, që do të përfaqësojnë Republikën e Shqipërisë në organizatat ndërkombëtare të vlerësimit të konformitetit.

Neni 8

Njohja e deklarimeve dhe e miratimeve të sistemeve të huaja të vlerësimit të konformitetit bëhet vetëm sipas marrëveshjeve të ndërsjella ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve të tjera.

Neni 9

1. Mosmarrëveshjet ndërmjet organizmit, që bën vlerësimin e konformitetit dhe subjektit të interesuar zgjidhen nga ministri përkatës, i cili, brenda një muaji nga data e paraqitjes së ankesës, merr vendimin përkatës.

2. Kundër vendimit të ministrit, palët e interesuara paraqesin padi në Gjykatën e Rrethit Tiranë brenda 30 ditëve nga data e shpalljes ose e njoftimit të vendimit.

KREU III DISPOZITA KALIMTARE

Neni 10

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore për:

- a) kërkesat teknike dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve;
- b) procedurat e kryerjes së vlerësimit të konformitetit;
- c) rregullat bazë të organizmit të autorizuar, që do të kryejë vlerësimin e konformitetit;
- ç) hartimin e listës së produkteve, që do t'i nënshtrohen vlerësimit të konformitetit.

Neni 11

Në pikën 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.323, datë 8.7.1999 "Për përgatitjen, përshtatjen dhe zbatimin e rregullave teknike dhe procedurat për vlerësimin e konformitetit me rregullat teknike dhe standardet", dispozitat "Për procedurat për vlerësimin e konformitetit nga ministritë dhe institucionet e tjera qendrore", "Për njohjen e vlerësimit të konformitetit nga ministritë dhe institucionet e tjera qendrore", "Për procedurat për vlerësimin e konformitetit nga organizmat joshtetërorë", "Për sistemet ndërkombëtare dhe rajonale të vlerësimit të konformitetit" dhe dispozitat e tjera, që bien ndesh me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 12

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekret nr.3911, datë 30.7.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,

Alfred Moisiu

L I G J
Nr.9098, datë 3.7.2003

**PËR INTEGRIMIN DHE BASHKIMIN FAMILJAR TË PERSONAVE QË KANË
PËRFITUAR AZIL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 40, 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i ligjit

Ky ligj rregullon procedurat për realizimin e të drejtave për arsimimin, punësimin, kujdesin shëndetësor e shoqëror, strehimin dhe bashkimin familjar të personave, që kanë përfituar azil në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2
Subjektet përfituese të ligjit

1. I huaji, që ka përfituar azil në Republikën e Shqipërisë, në mbështetje të ligjit nr. 8432, datë 14.12.1998 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”, është subjekt i dispozitave të përcaktuara në këtë ligj, përveç rasteve të kufizimeve të parashikuara me ligj.

2. Dispozitat e këtij ligji zbatohen dhe për azilkërkuesit për aq sa nuk bien në kundërshtim me kufizimet e përcaktuara nga legjislati në fuqi.

Neni 3
Zbatimi i ligjit për të huajt në mbrojtje të përkohshme, në raste fluksesh masive

1. Për të huajin në mbrojtje të përkohshme, në raste fluksesh masive, dispozitat e këtij ligji zbatohen për aq sa nuk bien në kundërshtim me parashikime të tjera ligjore, nëpërmjet nxjerrjes së vendimeve përkatëse nga Komisioni Kombëtar për Refugjatët.

2. Çdo ministër nxjerr udhëzim për trajtimin e të huajve në mbrojtje të përkohshme, në raste fluksesh masive, brenda përgjegjësisë dhe drejtimeve të ministrisë që drejton.

Neni 4
Përgjegjësitë

1. Zyra për Refugjatët, e krijuar me ligjin nr. 8432, datë 14.12.1998 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”, është përgjegjëse për zbatimin e të drejtave për të huajin, që ka përfituar azil në Republikën e Shqipërisë, sipas parashikimeve të këtij ligji dhe akteve të tjera përkatëse.

2. Institucionet shtetërore të përcaktuara në këtë ligj, janë të detyruara të kryejnë veprimet përkatëse me paraqitjen e dokumenteve dhe plotësimin e kërkesave të parashikuara nga ligji dhe aktet nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij.

KREU II ARSIMIMI DHE KUALIFIKIMI

Neni 5 **E drejta për arsimim**

I huaji, që ka përfituar azil në Republikën e Shqipërisë, gëzon të drejtën e arsimit në institucionet publike njëllor si shtetasi shqiptar.

Neni 6 **Arsimimi parauniversitar**

1. Institucionet arsimore publike parauniversitare janë të detyruara të regjistrojnë të huajin, që ka përfituar azil në Republikën e Shqipërisë, me paraqitjen nga vetë kërkuesi të dokumenteve përkatëse, të përcaktuara në nenin 39 të këtij ligji, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe.

2. Ministri i Arsimit dhe i Shkencës përcakton, me një udhëzim të veçantë, kriteret e vlerësimit të nivelit të arsimit të të huajit, që ka përfituar azil në Republikën e Shqipërisë. Vlerësimi bëhet nga drejtoria arsimore në nivel vendor, që mbulon institucionin në të cilin kërkon të regjistrohet i huaji, që ka përfituar azil në Republikën e Shqipërisë.

Neni 7 **Mësimi i gjuhës shqipe**

Zyra për Refugjatët organizon kurse të gjuhës shqipe, të edukimit qytetar dhe kurse kualifikimi për të huajt, që kanë përfituar azil në Republikën e Shqipërisë.

Neni 8 **Mbulimi i shpenzimeve nga Zyra për Refugjatët**

Zyra për Refugjatët mbulon shpenzimet që rrjedhin nga arsimimi dhe kualifikimi në një institucion shqiptar të arsimit ose të trajnimit, të sistemit parauniversitar, jashtë shpenzimeve të zakonshme publike, të parashikuara për këtë institucion, kur ka dhënë më parë pëlqimin për to ose ka lidhur një marrëveshje, në rastet kur:

- a) një grup i veçantë i çerdhës, grup klase ose godine është organizuar për fëmijët refugjatë dhe kur nxënësit nuk studiojnë bashkë me nxënësit shqiptarë;
- b) organizimi i një programi të veçantë për mësimin bëhet i nevojshëm për shkak të mësimi të fëmijëve në gjuhën amtare;
- c) për shkak të mësimi të gjuhës shqipe.

Neni 9 **Arsimimi universitar**

1. I huaji, që ka përfituar azil në Republikën e Shqipërisë, ka të drejtë të konkurrojë për arsimin e lartë, sipas kriterëve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës.

2. Zyra për Refugjatët mund të mbulojë shpenzimet, që rrjedhin nga arsimi i lartë, për fakultet të parë të të huajit që ka përfituar azil në Republikën e Shqipërisë. Mbulimi i shpenzimeve përfshin periudhën kohore, që parashikohet për marrjen e diplomës përkatëse.

3. Shuma e shpenzimeve dhe kriteret për dhënien e kësaj mbështetjeje përcaktohen nga Zyra, sipas rregullave që zbatohen për studentin shqiptar që përfiton bursë.

4. I huaji i interesuar, që ka përfituar azil në Republikën e Shqipërisë, i paraqet Zyrës për Refugjatët një kërkesë, së cilës i bashkëlidhet një rekomandim nga drejtuesi i institucionit përkatës dhe

një certifikatë pranimi.

5. Kusht për pagesën e përfitimit të caktuar është që studenti, deri ditën e fundit të shtatorit dhe shkurtit të çdo viti, të provojë se studion në institucionin e arsimit të lartë dhe ka shlyer detyrimet ndaj programit mësimor.

KREU III PUNËSIMI

Neni 10

E drejta për punë

I huaji, që ka përfituar azil në Republikën e Shqipërisë, ka të drejtën për një leje pune të posaçme, që nga çasti i marrjes së statusit. I huaji, që ka përfituar azil në Republikën e Shqipërisë, gëzon të njëjtat mundësi ligjore në tregun e punës sikurse shtetasi shqiptar.

Neni 11

Leja e punës

1. Drejtoria e Migracionit në Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale pajis me leje pune të huajin, që ka përfituar azil në Republikën e Shqipërisë, me kërkesën e këtij të fundit, të dërguar nëpërmjet Zyrës për Refugjatët.

2. Për marrjen e lejes së punës plotësohet një formular i veçantë, i miratuar nga Ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale. Formulari tërhiqet pranë Drejtorisë së Migracionit ose pranë Zyrës për Refugjatët.

Neni 12

Paraqitja e dokumentacionit

Zyra për Refugjatët e asiston të huajin, që ka përfituar azil në Republikën e Shqipërisë, në plotësimin e formularit për marrjen e lejes së punës së posaçme. Dërgimi i formularit së bashku me dokumentet përkatëse në Drejtorinë e Migracionit bëhet nga Zyra brenda 10 ditëve nga plotësimi i formularit. Koha e shqyrtimit të dokumentacionit është deri në 15 ditë nga data e depozitimit të kërkesës.

Neni 13

Karakteristikat e lejes së punës

1. Leja e posaçme e punës ka, përveç të tjerave, këto karakteristika:

- a) jepet për një afat kohor deri në 5 vjet dhe ripërtërihet në përfundim të këtij afati, me kërkesën e personit të interesuar;
- b) shtrihet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë;
- c) përfshin të drejtën e vetëpunësimit.

2. Leja e punës për të huajin, që ka përfituar azil në Republikën e Shqipërisë, jepet pa kundërvleftë.

Neni 14

Regjistrimi pranë zyrës së punësimit

I huaji, që ka përfituar azil në Republikën e Shqipërisë, regjistrohet pranë zyrës së punësimit, ku ka vendbanimin.

KREU IV TRAJTIMI SOCIAL

Neni 15

E drejta për trajtim social

1. I huaji, që ka përfituar azil në Republikën e Shqipërisë, gëzon të drejtën e trajtimit social njëlloj si shtetasi shqiptar, në përputhje me legjislacionin përkatës.
2. Në kuptim të këtij ligji, me trajtim social kuptohen:
 - a) sigurimet shoqërore;
 - b) përkrahja sociale;
 - c) sigurimet shëndetësore.

Neni 16

Sigurimet shoqërore e shëndetësore

I huaji, që ka përfituar azil në Republikën e Shqipërisë, i punësuar dhe i siguruar, gëzon të drejtën për të përfituar nga sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të detyrueshme, në përputhje me ligjet nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, dhe nr. 7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 17

Përkrahja sociale

1. I huaji, që ka përfituar azil në Republikën e Shqipërisë, ka të drejtën e përkrahjes sociale, në formën e ndihmës ekonomike, brenda 5 ditëve nga marrja e vendimit për përfitimin e azilit.
2. Kjo ndihmë jepet për familjen e të huajit, që ka përfituar azil në Republikën e Shqipërisë, të cilit i mungojnë krejtësisht të ardhurat dhe mjetet e jetesës ose i ka ato të pamjaftueshme.
3. Procedurat dhe kriteret për vlerësimin e nivelit të ndihmës, mungesës së të ardhurave dhe burimeve materiale për të përfituar ndihmë ekonomike, si dhe sasia minimale e pagesës së kësaj të fundit përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale dhe ministrit përkatës, nga varet Zyra për Refugjatët.
4. I huaji, që ka përfituar azil në Republikën e Shqipërisë, për sa kohë trajtohet në qendrat për refugjatët nuk përfiton ndihmë ekonomike. Përfundimisht bëhet vetëm në raste të veçanta, të përcaktuara në udhëzimin e përbashkët të të dy ministrave.

Neni 18

Mbajtja e dokumentacionit dhe shpërndarja e ndihmës ekonomike

1. Zyra për Refugjatët është përgjegjëse për mbajtjen e dokumentacionit dhe për shpërndarjen e ndihmës ekonomike personit përfitues. Kjo zyrë duhet t'u raportojë ministrave përkatës për mënyrën e shpërndarjes së ndihmës ekonomike, të paktën një herë në vit.
2. Vendimi për dhënien e ndihmës ekonomike merret nga Zyra, sipas kriterëve të vlerësimit, të përcaktuara në nenin 17 të këtij ligji.
3. Zyra për Refugjatët ka detyrë t'i propozojë ministrit përkatës, nga varet Zyra, buxhetin e shpenzimeve për ndihmën ekonomike.

Neni 19

Përfitimi nga ligji për ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore

I huaji që ka përfituar azil në Republikën e Shqipërisë është subjekt i nenit 4 pika 2 të ligjit nr. 7710, datë 18.5.1993 “Për ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore”, ku afati 10-vjeçar, i parashikuar në

këtë rast, llogaritet që nga çasti i aplikimit, sipas dokumentacionit përkatës, të mbajtur nga Zyra për Refugjatët.

Neni 20

Vendosja në institucionet e përkujdesjes

1. I huaji, që ka përfitur azil në Republikën e Shqipërisë e që përmbush kriteret e legjislacionit në fushën e përkujdesjes shoqërore, mund të vendoset në institucionet publike të përkujdesjes. Dokumentacioni i pranimit në këto institucione hartohet nga Zyra për Refugjatët, sipas të dhënave të mbajtura në regjistrat e kësaj Zyre dhe miratohet nga Komisioni Qendror pranë Shërbimit Social Shtetëror.

2. Zyra për Refugjatët mund të lidhë kontrata për trajtimin e të huajit, që ka përfitur azil në Republikën e Shqipërisë, me institucione jopublike të përkujdesjes shoqërore, që administrohen nga organizata jofitimprurëse të licencuara, nga Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale dhe që e ushtrojnë veprimtarinë e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 21

Sigurimet shoqërore e shëndetësore suplementare

I huaji, që ka përfitur azil në Republikën e Shqipërisë, ka të drejtë ta sigurojë veten dhe familjen e vet me skema të sigurimeve suplementare, shoqërore e shëndetësore, për mjekimet me kosto të lartë, që nuk mbulohen nga sigurimet e detyrueshme ose përfitime të tjera shtesë, sipas legjislacionit në fuqi.

KREU V

PËRFITIMI I STREHIMIT

Neni 22

E drejta për strehim

I huaji, që ka përfitur azil në Republikën e Shqipërisë, ka të drejtë të gëzojë mundësitë ligjore për përfitimin e strehimit, si shtetas shqiptar.

Neni 23

Strehimi në qendrat për refugjatët

I huaji, që ka përfitur azil në Republikën e Shqipërisë, në mungesë të mundësive të veta për strehim, ka të drejtë të qëndrojë në qendrat për refugjatët ose në ato të strehimit të përkohshëm.

Neni 24

Ndihma në strehim, nëpërmjet pagesës së pjesshme të qirasë

Zyra për Refugjatët, për të huajin, që ka përfitur azil në Republikën e Shqipërisë, mund të mbulojë pjesërisht shumën e qirasë për strehimin e tij. Përfitimi mund të jepet për një periudhë gjashtëmujore. Me kërkesë të personit, periudha e përfitimit mund të shtyhet edhe për gjashtë muaj të tjerë. Shuma e përfitimit mund të jetë deri në 50 për qind të vlerës së qirasë së përcaktuar në kontratë ose të shpenzimeve të strehimit.

Neni 25

Kriteret për përcaktimin e shumës së përfitimit

Në përcaktimin e shumës së përfitimit dhe të kushteve të dhënies së përfitimit duhet të merren parasysh: të ardhurat e personit, gëzimi nga ana e tij e ndonjë të drejte që i siguron sasi të hollash në mënyrë periodike, veprimtaria fitimprurëse, si dhe rrethanat familjare. Kërkesa për strehim duhet të jetë brenda kriterëve të nevojës për strehim sikurse ajo që përfiton edhe shtetasi shqiptar. Kriteret për

dhënien e kësaj ndihme dhe për shumën e përfitimit përcaktohen nga ministri përkatës nga varet Zyra për Refugjatët.

KREU VI PROCEDURAT PËR BASHKIMIN FAMILJAR PËR PERSONIN QË KA PËRFITUAR AZIL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Neni 26

Përfituesi nga e drejta e bashkimit familjar

1. Personi, që ka përfitur azil në Republikën e Shqipërisë ka të drejtë të kërkojë bashkim familjar me bashkëshortin ose bashkëshorten, fëmijët e pamartuar nën moshën 18 vjeç ose ndonjë person tjetër në ngarkim të tij.

2. Fëmija i pashoqëruar, që ka përfitur azil në Republikën e Shqipërisë, ka të drejtë të kërkojë bashkim familjar me prindërit, motrat, vëllezërit, njerkun, njerken, anëtarë të tjerë të familjes, të cilët bashkëjetojnë me të ligjërisht, ose që janë të mitur dhe të pamartuar. Kur këta persona të familjes, të shkallës së parë, në vijë të drejtpërdrejtë nuk mund të gjenden, fëmija i pashoqëruar ka të drejtë të kërkojë bashkim familjar me kujdestarin ligjor ose me ndonjë të afërm tjetër, jo në vijë të drejtpërdrejtë.

3. Në rast të një martese poligame, kur një nga bashkëshortët e aplikantit jeton me të në Republikën e Shqipërisë, organet përkatëse nuk autorizojnë hyrjen, qëndrimin dhe dhënien e bashkimit familjar të bashkëshortit ose bashkëshortes tjetër dhe as të fëmijëve të këtij bashkëshorti ose bashkëshorteje, pa paragjykuar dispozitat e Konventës “Mbi të drejtat e fëmijës” të vitit 1989.

4. Në rast të një martese poligame, kur bashkëshortët jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, aplikanti ka të drejtë të kërkojë bashkim familjar me bashkëshortin ose bashkëshorten e martesës së parë dhe me fëmijët e këtij bashkëshorti ose bashkëshorteje, sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij neni.

Neni 27

Interesi më i mirë i fëmijës

Gjatë shqyrtimit të një aplikimi, Zyra për Refugjatët, Komisioni Kombëtar për Refugjatët dhe gjykatat përkatëse kanë parasysh interesin më të mirë të fëmijës, në përputhje me Konventën “Mbi të drejtat e fëmijës” të vitit 1989.

Neni 28

Refuzimi i kërkesës për bashkim familjar

1. Autoritetet përkatëse mund të refuzojnë një aplikim për bashkim familjar, për arsye të sigurisë publike, sigurisë kombëtare dhe shëndetit publik. Arsyet për sigurinë publike ose sigurinë kombëtare bazohen ekskluzivisht në sjelljen personale të anëtarit të familjes që merret në shqyrtim.

2. Aplikimi për bashkim familjar mund të refuzohet edhe në rrethanat e mëposhtme:

- a) kur nuk përmbushen kushtet e përcaktuara nga ky ligj;
- b) kur aplikanti dhe anëtari ose anëtarët e familjes së tij në vendin pritës gjatë qëndrimit në vendin e origjinës, nuk kanë jetuar në marrëdhënie të plota martesore ose familjare;
- c) kur vërtetohet se janë paraqitur të dhëna të pavërteta a çorientuese, dokumente të falsifikuara, janë përdorur mashtrime ose mjete të tjera të kundërligjshme;
- ç) kur provohet se martesa ose birësimi janë bërë me qëllimin e vetëm për t'i mundësuar personit të interesuar hyrjen dhe qëndrimin në Shqipëri.

3. Zyra për Refugjatët mund të ndërmarrë kontrolle të veçanta, kur ka arsye të dyshojë se ka të bëjë me njërën nga rrethanat e parashikuara në pikën 2 të këtij neni.

Neni 29

Procedurat administrative gjatë shqyrtimit të aplikimit

Gjatë procedurave, që lidhen me paraqitjen e aplikimit për bashkim familjar, shqyrtimin e aplikimit, hetimet e rasteve konkrete nga Zyra për Refugjatët, afatet e marrjes së vendimit për aplikimin, njoftimin e aplikimeve dhe apelimin në Komisionin Kombëtar për Refugjatët, të rregulluara në nenet 30 – 34 të këtij ligji, zbatohen dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurave Administrative, për aq sa këto procedura nuk marrin rregullim të posaçëm nga ky ligj.

Neni 30

Paraqitja e aplikimit për bashkim familjar

1. Personi, që ka përfituar azil në Republikën e Shqipërisë, paraqet aplikimin për bashkim familjar në Zyrën për Refugjatët dhe plotëson një formular të veçantë aplikimi. Ky formular përfshin të dhënat biografike të personit, me të cilin kërkohet bashkimi familjar dhe të dhëna për lidhjen familjare me aplikantin.

2. Personi, që ka përfituar azil në Republikën e Shqipërisë, ka të drejtën të kërkojë bashkim familjar pas vendimit përfundimtar të dhënies së statusit në Shqipëri.

3. Formulari i aplikimit duhet të shoqërohet me dokumentet e udhëtimit të anëtarëve të familjes dhe me prova të dokumentuara të lidhjes familjare të aplikantit me personin ose personat, me të cilin a të cilët kërkohet bashkimi familjar.

4. Kur një aplikant, që ka përfituar azil në Republikën e Shqipërisë, nuk mund të paraqesë prova të dokumentuara të lidhjes familjare, Zyra për Refugjatët merr parasysh të tjera të dhëna ekzistuese për lidhjen familjare. Një vendim refuzimi ndaj aplikimit në këtë rast nuk mund të bazohet vetëm në faktin e mungesës së provave të dokumentuara.

Neni 31

Shqyrtimi i aplikimit

1. Për përfitimin e të dhënave për ekzistencën e një lidhjeje familjare, Zyra për Refugjatët mund të kryejë intervista me aplikantin dhe anëtarët e tij të familjes dhe të bëjë hetime, që vlerësohen të nevojshme. Zyra për Refugjatët regjistron të gjitha të dhënat e përfituara.

2. Gjatë procedurës për përfitimin e bashkimit familjar, aplikanti mund të ndihmohet, këshillohet ose të përfaqësohet nga një avokat.

Neni 32

Afati për marrjen e vendimit, apelimi në Komisionin Kombëtar për Refugjatët, ankimi në gjykatë

1. Vendimi për aplikimin për bashkim familjar në Zyrën për Refugjatët merret jo më vonë se 30 ditë nga data e paraqitjes së aplikimit.

2. Në rastin kur aplikimi për bashkim familjar ka lidhje me një të mitur, të pashoqëruar, vendimi merret jo më vonë se 20 ditë nga data e paraqitjes së aplikimit.

3. Zyra për Refugjatët njofton me shkrim aplikantin për vendimin e saj brenda 5 ditëve nga data e marrjes së vendimit.

4. Në raste të veçanta, që lidhen me vështirësinë ose kompleksitetin e analizimit të aplikimit, afatet që parashikohen në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni mund të shtyhen, por, në çdo rast, ky afat nuk duhet të kalojë 60 ditë.

5. Në rast refuzimi të aplikimit, vendimi duhet të jetë i arsyetuar.

6. Në rast se Zyra për Refugjatët vendos për refuzimin e aplikimit për bashkim familjar, aplikanti ka të drejtë të apelojë kundër këtij vendimi në Komisionin Kombëtar për Refugjatët jo më vonë se 5 ditë nga data e njoftimit me shkrim nga Zyra për Refugjatët. Apelimi kundër vendimit të kësaj Zyre i drejtohet Komisionerit Kombëtar për Refugjatët.

7. Komisioni Kombëtar për Refugjatët shqyrton dhe vendos për apelimin në mbledhjen e tij më të parë.

8. Kur kërkesa për apelim lidhet me bashkimin familjar të të miturve, të pashoqëruar, Komisioni Kombëtar për Refugjatët shqyrton kërkesën për apelim dhe vendos jo më vonë se 30 ditë nga data e depozitimit të kërkesës.

9. Në marrjen e vendimit për aplikimin për bashkim familjar të një aplikanti që ka përfituar azil në Republikën e Shqipërisë, Komisioni Kombëtar për Refugjatët zbaton rregullat e parashikuara në pikën 4 të nenit 30 të këtij ligji.

10. Në rast se Komisioni Kombëtar për Refugjatët vendos për të mos pranuar kërkesën për bashkim familjar, aplikanti ka të drejtë të ankohet kundër këtij vendimi administrativ në gjykatën e faktit ku ka vendbanimin.

11. Shqyrtimi gjyqësor bëhet në përputhje me dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Civile dhe parimeve të parashikuara nga ky ligj.

Neni 33

Hyrja dhe qëndrimi i anëtarëve të familjes

1. Zyra për Refugjatët njofton me shkrim Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Ministrinë e Rendit Publik për vendimin për pranimin e bashkimit familjar.

2. Personat, që përfitojnë nga vendimi për bashkimin familjar, pajisen me vizë hyrjeje në kufi, në rast se kërkohet një e tillë. Ata pajisen me leje qëndrimi në bazë të të njëjtave rregulla dhe procedura që zbatohen për dhënien e lejeve të qëndrimit për personin që ka përfituar azil në Republikën e Shqipërisë.

Neni 34

Dhënia e azilit nëpërmjet bashkimit familjar

1. Zyra për Refugjatët u jep statusin e azilit anëtarëve të familjes së aplikantit me mbërritjen në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me nenin 6 të ligjit nr. 8432 datë 14.12.1998 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”.

2. Vendimi merret në vijim të kërkesës së depozituar pranë Zyrës për Refugjatët nga anëtari ose anëtarët e familjes së aplikantit jo më vonë se 10 ditë nga data e depozitimit të kësaj kërkesë. Ky vendim i njoftohet me shkrim personit, i cili ka bërë kërkesën.

KREU VII

PËRGJEGJËSI TË TJERA TË ZYRËS PËR REFUGJATËT

Neni 35

Marrëveshjet e Zyrës për Refugjatët me subjekte të treta

1. Zyra për Refugjatët lidh marrëveshje me subjekte të treta për shërbime që lidhen me personin ose personat që u është dhënë azil në Republikën e Shqipërisë, veçanërisht shërbime për dhënien e informacionit, regjistrimin dhe trajnimin e vazhdueshëm të personave, që merren me çështjet e refugjatëve.

2. Zyra për Refugjatët lidh marrëveshje me institucione, shtetërore e private, organizata, vendase dhe të huaja, për shërbimet dhe ndihmën e përcaktuar në këtë ligj dhe për mbulimin e shpenzimeve, që rrjedhin prej tyre.

Neni 36

Administrimi i qendrave të pritjes së refugjatëve dhe azilkërkuesve

Zyra për Refugjatët kujdeset për administrimin dhe mirëmbajtjen e qendrave për pritjen e refugjatëve dhe azilkërkuesve, si dhe të strehimeve të përkohshme, që ofrojnë kujdes, mbajtje dhe strehim.

Neni 37

Rimbursimi i shpenzimeve nga Zyra për Refugjatët

Zyra për Refugjatët rimbursion shpenzimet për kujdesin dhe ndihmën, përfitimet ose shërbimet që parashikohen nga ky ligj, përveç shpenzimeve publike të parashikuara më parë. Rimbursimi i shpenzimeve mund t'i kërkohej Zyrës, në bazë të faturave të hartuara çdo muaj, të cilat tregojnë emrin e përfituesit dhe numrin e serisë së njërës prej dokumenteve të renditura në nenin 39 të këtij ligji ose numrin e dosjes së tij, në formën e përcaktuar nga kjo Zyra.

Neni 38

Përzgjedhja e organizatave ofruese të shërbimit

1. Zyra për Refugjatët, në kontraktimin me organizatat që kryejnë shërbime të caktuara, i përzgjedh ato sipas ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 "Për prokurimin publik", në rastin e fondeve publike.
2. Kontratat bëhen me shkrim dhe përmbajnë të dhënat e mëposhtme:
 - a) të dhënat e regjistrit të gjykatës, ku është themeluar organizata e kontraktuar ose të dhënat e licencës së lëshuar nga autoritetet përkatëse, kur bëhet fjalë për një organizatë që e ushtron veprimtarinë e saj në bazë të një licence të lëshuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
 - b) mënyrën e përcaktimit të shumës së shpërblimit që jepet për kujdesin, ndihmën dhe shërbimet e siguruar si subjekt i kontratës;
 - c) dispozitat për transferimin dhe përcaktimin e shpërblimit;
 - ç) mënyrën e mbarimit të kontratës dhe të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve ligjore.

Neni 39

Vërtetimi i identitetit

1. Personi, që aplikon për përfitimet e parashikuara në këtë ligj, duhet të vërtetojë identitetin jo vetëm me dokumentet e kërkuara, sipas parashikimeve të veçanta, por edhe me dokumentet e mëposhtme:
 - a) me kartën e identitetit. Kjo kartë identiteti barazohet me të gjitha dokumentet e identifikimit, të vlefshme, sipas legjislacionit për shtetasit shqiptarë;
 - b) sipas rastit, dokumentin për gjendjen familjare.
2. Zyra për Refugjatët dhe autoritetet përkatëse hartojnë dokumentet e duhura që u nevojiten personave, që kanë përfituar azil në Republikën e Shqipërisë, në marrëdhëniet e tyre me të tretët dhe me administratën shtetërore.

Neni 40

Menaxhimi i dhurimeve

1. Zyra për Refugjatët menaxhon dhurimet vendase ose të huaja, që jepen në të holla ose në natyrë, në ndihmë të personave që u është dhënë azil, në përputhje me kushtet e përcaktuara nga dhuruesi.
2. Zyra për Refugjatët mban regjistra të veçantë për dhurimet, në të holla ose në natyrë dhe për përdorimin e tyre. Këta regjistra janë objekt i kontrollit të strukturave përkatëse administrative.

KREU VIII

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 41

Buxheti i Zyrës për Refugjatët

Ministri i Financave, në bashkëpunim me ministrin përkatës nga varet Zyra për Refugjatët, përcakton një fond të veçantë në buxhetin e Zyrës, për kryerjen e shpenzimeve, sipas parashikimeve të bëra në këtë ligj.

Neni 42
Aktet nënligjore

Ministrat përkatës, sipas parashikimeve në nenet 6, 11, 13, 17, 25 dhe 41 të këtij ligji, nxjerrin aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji, brenda 60 ditëve nga hyrja në fuqi e tij.

Neni 43
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3912, datë 30.7.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

L I G J
Nr.9099, datë 3.7.2003

PËR NJË SHITESË DHE NDRYSHIM NË LIGJIN NR.8894, DATË 14.5.2002
“PËR AGJENCINË E TRAJTIMIT TË KREDIVE”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pikat 1 dhe 2 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8894, datë 14.5.2002 “Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive” bëhet kjo shtesë dhe ky ndryshim:

Neni 1

Në nenin 1 shtohet fjalia e dytë me këtë përmbajtje:

“Agjencia e Trajtimit të Kredive, në përputhje me përcaktimet e bëra në këtë ligj, trajton edhe portofolin e investimeve të kryera në banesa nga shoqëria INSIG sha.”.

Neni 2

Fjalia e fundit e pikës 2 të nenit 23 riformulohet si më poshtë:

“Këto kërkesa i kalojnë Ministrisë së Financave, e cila, pas përfundimit të afatit të veprimtarisë së Agjencisë së Trajtimit të Kredive, i propozon Këshillit të Ministrave mënyrën e menaxhimit të pjesës së mbetur.”.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3913, datë 30.7.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

Kodi Penal <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Mars, 2002	Kodi i Procedurës Penale <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Shtator, 2002	Kodi i Procedurës Civile <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Korrik, 2002	Kodi Rrugor <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Qershor, 2002
Kodi Penal Ushtarak <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002	Përmbledhëse legjislacioni në fushën e Përmbarimit <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002		

Doli nga shtypi më 4.8.2003

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2003

Çmimi: 150 lekë